



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave**

**“Psikologji klinike”**

**Universiteti Privat “Albanian University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Assoc. Dr. Erika Melonashi

Dr. Jonida Lesha

Tetor/2024

## **RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Për Programin e studimit Master i shkencave në “Psikologji Klinike”**

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master shkencor në “Psikologji Klinike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 597, datë 28.05.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	N/A
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 404, dt.28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 85, datë 07.12.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/4 simestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020 2021 6 PAE 3 PAK 2021-2022 5 PAE 3 PAK 2022-2023 6 PAE 4 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 - 25 studentë; 2021-2022 - 11 studentë; 2022-2023 19 studentë
19	Komente / të tjera:	-



## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti “Albanian Univerity” (AU) ish shkolla e lartë universitare jopublike “Ufo dental” është licensuar me VKM Nr. 197, datë 10.04.2004. Ka ndryshuar statusin dhe është riorganizuar sipas VKM Nr.597, datë 28.5.2009 për ndryshimin e emrit të Universitetit Privat “UFO University” dhe gjithashtu mbështetur në VKM Nr. 603, datë 24.8.2011, për ndryshimin e emrit të universitetit privat nga “UFO University” në “Albanian University”. Riorganizimi institucional është mbështetur në urdhrin e MAS Nr.52, datë 05.02.2016. Albanian University është akredituar për herë të parë nga Bordi i Akreditimit me vendim Nr. 90, datë 20.10.2017 “Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë Universiteti Privat “Albanian University”. Riakreditimi i dytë bazohet në Vendimin e BA-së, Nr. 01, date 24.01.2020 “Për Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Privat “Albanian University” me kohëzgjatjen prej 3 (tre) vite.

Albanian University përbëhet nga 3 Fakultete:

- Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”, ofruar nga Albanian University është program studimi i ciklit të dytë me kohë të plotë, kohëzgjatje 2 vite akademike dhe 120 kredite. Programi është licensuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me Vendim Nr.597, datë 28.05.2009 dhe Urdhër nr.308 datë 08.06.2010. Akreditimi i fundit i këtij programi është kryer në vitin 2018, për një kohëzgjatje 5 vjecare, sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr.85 datë 07.12.2018.

Ky program zgjeron dhe thëllon më tej njohuritë e marra në ciklin e parë të studimit Bachelor në “Psikologji të Përgjithshme”, duke u fokusuar në specialitetin e “Psikologjisë Klinike”. Kurrikula e programit kombinon elementë teorikë dhe praktikë përfshi intervistimin klinik, supervizimin, këshillimin në grup, çift apo familje etj. Përmes aftësimit praktik gjithashtu studenti formësohet drejt profesionit të ardhshëm si psikolog klinik, dhe i mundësohet të ndjekë të gjitha procedurat drejt licensimit sipas përcaktimeve në Rregulloret përkatëse të Urdhërit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë.

Përtej aftësimit për punësim në profesion, studentët gjithashtu pajisen me njohuri të avancuara në metodologjinë e kërkimit shkencor duke mundësuar vazhdimin në ciklin e tretë të studimeve të doktoratës në këtë fushë studimore. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat për të dizenuar një studim shkencor testohen përmes punimit të diplomës, si detyrim përmbyllës në këtë program studimi.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit 2 vjecar Master Shkencor në “Psikologji klinike” është vlersimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”. Grupi i vlerësimit të jashtëm i përbërë nga ekspertet Prof. Asoc. Dr. Erika Melonashi, Dr. Jonida Lesha dhe Msc.Anilda Beqiraj (koordinatore teknike), nisi punën për realizimin e procesit të vlersimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit.

Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Universitetin “Albanian University”, MASR, publikun e gjerë dhe studentët sesi programi i studimit përmbush standardet. Përmes këtij raporti njësia kryesore dhe bazë kanë mundësi të identifikojnë prioritetet në drejtim të rritjes dhe zhvillimit, duke e vënë theksin tek përmirësimi i cilësisë në drejtim të një procesi që zhvillon kompetencat profesionale për studentët. Standartet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë të grupuara në gjashtë fusha kryesore vlerësimi bazuar tek Ofrimi, Organizimi dhe Drejtimi i Programit të Studimit Master shkencor; Struktura dhe Përmbajtja e Programit të Studimit Master Profesional; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet për Realizimin e Programit të Studimit dhe Mbështetja e Studentëve; Studentët dhe Mbështetja e tyre, Sigurimi i Cilësisë së Programit të Studimit Master Shkencor. Vlerësimi i secilës fushë bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve me 4 nivele: a- nuk përmbushen; përmbushen pjesërisht; përmbushen kryesisht; përmbushen plotësisht. Raporti në tërësinë e tij identifikon pikat e forta të programit të studimit bazuar në karakteristikat e praktikës së mirë, pikat e dobëta të cilat prekin cdo fushë, mundësitë që ka në dispozicion programi në drejtim të avancimit drejt cilësisë dhe pengesat, të cilat mund të vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbi bazën e këtyre indikatorëve grupi i vlerësimit të jashtëm ka dhënë edhe rekomandimet profesionale që do të shërbejnë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të programit të studimit Master Shkencor në “Psikologji klinike”.

## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit me Vendimin Nr. 85, datë 07.12.2018 janë:

- A. Institucioni, të rregullojë me marrëveshje të posaçme dhe të detajuara zhvillimin e praktikave të studentëve pranë institucioneve të specializuara në fushën e psikologjisë klinike dhe të garantojë zbatimin e tyre duke filluar që nga viti akademik 2018-2019.
- B. Institucioni, të rrisë mbështetjen e tij për zhvillimin e kualifikimin akademik të stafit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi dhe rritjen e numrit të tij me specialistë të kësaj fushe specifike.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

- A. **Rekomandimi i parë është përmbushur pjesërisht nga Institucioni.** Vlerësohet se pavarësisht rritjes së numrit total të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione brënda dhe jashtë vendit, mungon qartësisht përfshirja e institucioneve të specializuara në fushën e psikologjisë klinike. Gjithashtu departamenti nuk ka marrë masa për të hartuar një raport analitik për marrëveshjet e bashkëpunimit ekzistuese, specifikisht në kuadër të programit të studimit. Rëndësia e kryerjes së praktikës profesionale në institucione të cilat kanë profilin klinik është mjaft e qartë; studentët përfitojnë maksimalisht nga kryerja e praktikave në këto institucione, sa i takon kompetencave profesionale apo edhe punësimit të tyre të ardhshëm. Nga ana tjetër duhet theksuar vështirësia praktike në realizimin e praktikave mësimore në kontekste klinike, e cila lidhet me çështjet etike të profesionit (konfidencialiteti), apo papërshtatshmërinë e ambjenteve fizike.

*Evidenca R1a. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidenca 1.7. Raporti analitik I marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të programit të studimit; Evidenca (shitesë) 23. Raporti analitik i praktikave në Msc. Psikologji Klinike.*

- B. **Rekomandimi i dytë është përmbushur kryesisht nga Institucioni.** Institucioni ka demonstruar rritjen e mbështetjes për stafin akademik sa i takon kualifikimeve të tyre, sikundër raportohet për 2 pedagogë të cilët janë kualifikuar si Doktor Shkencash dhe Profesor i Asociuar respektivisht. Gjithashtu institucioni paraqiti evidencë për mbështetjen financiare të pedagogëve, për botime në revista me faktor impakti, cka lehtëson padyshim kualifikimin e mëtejshëm akademik të tyre. Institucioni gjithashtu ka bërë përpjekje për të rritur numrin e stafit akademik të specializuar në psikologji klinike përmes thirrjeve për rekrutim. Gjithsesi konstatohet se stafi me profil klinik ende nuk ka një peshë të mjaftueshme në këtë program (përfshi këtu edhe pedagogët e jashtëm të angazhuar në programin e studimit).

*Evidenca 4.2. Cv e stafit akademik; Evidenca R2a/R2b. Procedurë rekrutimi fillimi I vitit akademik 2021-2022/2022-2023; Evidenca për shumën e fondit të kërkimit shkencor (shitesë).*



Referuar shkresës së Institucionit të Arsimit të Lartë Privat, Universiteti Privat “Albanian University”, me Nr. 359/1 Prot., datë 15.10.2024, drejtuar Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në përgjigje të procesit të rishikimit të përmbajtjes së Draft/Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë së programit të studimit Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Psikologji klinike”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi me vëmendje të posaçme momentet e diskutueshme të përshkruara në këtë shkresë dhe konkludoi si më poshtë:

1. *Standardi I.2 Kriteri 5: Gjithsesi në mes të aktiviteteve të ndryshme organizuar për studentët e diplomuar mungojnë trajnimet profesionale në bashkërendim me punëdhënësit.*

**Pas rishikimit të evidencave të reja të paraqitura në nivel ndërkombëtar,**

**Evidence nr.1.a VIRTUEDU AU&Univ. de Aveiro Portugali.pdf; Evidence nr.1.b ISIA,FAENZA.pdf; Evidence nr.1.c Institute of public health Univ of Porto.pdf**

**u konstatua se edhe keto marrëveshje janë në kuadër të shkëmbimit në funksion të mësimdhënies dhe jo trajnimit profesional në fushën e Psikologjisë Klinike.**

**GVJ arriti në përfundimin se Institucioni nuk ka paraqitur evidencë shtesë specifike për “trajtime profesionale në bashkërendim me punëdhënësit”.**

2. *Standardi II.3, Kriteri 3: GVJ evidentoi se mungojnë kriteret specifike për pranimin në programin e studimeve Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”.*

**Institucioni ka paraqitur evidencë Evidence nr.2 Vendim Senati.pdf për ngritjen e një grupi pune për rishikimin e rregulloreve. Për këtë arsye GVJ shprehet se mangësia e mësipërme e konstatuar gjatë duhet marrë parasysh dhe reflektuar në procesin e rishikimit të Rregullores së Programit të Studimit “Master i Shkencave në Psikologji Klinike”.**

3. *Standardi II.4 Kriteri 5: Syllabuset e lëndëve nuk janë përditësuar në nivelin e duhur, sidomos përsa i takon literaturës së përdorur (si bazë dhe ndihmëse) e cila është e vjetër mbi një dekadë në disa raste. Gjithashtu nga shqyrtimi i syllabuseve konstatohet se mungojnë rezultatet e të nxënit, duke u mjaftuar vetëm me një përmbledhje apo përshkrim të modulit/lëndës.*

**Evidenca shtesë e paraqitur (Evidence nr. 3 Syllabus.pdf) është syllabusi i një lënde të vetme ku sërish literatura është 15-20 vite e vjetër, dhe ka një përpjekje për të përfshirë rezultatet e të nxënit (megjithëse formulimi është jo plotësisht i saktë). GVJ i qëndron përfundimit të nxjerrë nga shqyrtimi i plotë i dosjes së syllabuseve, si dhe rekomandimit për rishikimin e të gjitha syllabuseve përsa i takon literaturës dhe rezultateve të të nxënit.**

4. *Standardi II.5 Kriteri 2* Gjithsesi në lidhje me programin specifik të studimit Master i Shkencave në "Psikologji Klinike" nuk u paraqitën shembuj konkretë mbi rolin e studentëve apo alumni në përmirësimin e këtij programi studimi.

**Institucioni nuk paraqiti evidencë të shembujve konkretë të rolit të studentëve në përmirësimin e Programit të Studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike. Evidenca e paraqitur është thjesht modeli i pyetësorit të studentëve. GVJ i qëndron konkluzionit të nxjerrë gjatë vizitës në Institucion.**

5. *Standardi II.6 Kriteri 2: Gjithsesi u konstatua nga takimi me pedagogët por edhe anëtarët e Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, se departamenti duhet të angazhohet më tepër në nxitjen dhe mbështetjen e aktivitetit të kërkimit shkencor. Ky funksion po ushtrohet kryesisht nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit e cila operon në nivel Institucional.*


**Në mungesë të Evidencës shtesë në lidhje me angazhimin e Departamentit në nxitjen dhe mbështetjen e kërkimit shkencor, GVJ i qëndron përfundimit të nxjerrë gjatë vizitës në Institucion.**

#### **6. Standardi IV.1, Kriteri I**

*Në seleksionimin e stafit akademik me kohë të pjesshme nuk janë aplikuar të njëjtat kritere dhe standard për të siguruar kështu një garanci në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Një pjesë e personelit akademik me kohë të pjesshme (Pak) e angazhuar në realizimin e programit të studimit Master I Shkencave në Psikologji Klinike, rezulton të jetë me nivel MSc kualifikimit.*

**Si GVJ, do të theksonim se duke shqyrtuar të dhënat e paraqitura, është e qartë se në vitet e kaluara, niveli i kualifikimeve të stafit akademik me kohë të pjesshme ka qenë i ndryshëm. Kjo tregon një nevojë për një qasje më të konsoliduar në procesin e seleksionimit dhe angazhimit të stafit, për të garantuar që çdo anëtar i stafit të ketë gradën e përshtatshme për ciklin e studimit, si dhe përvojë relevante në fushën përkatëse.**

**Deklarata e universitetit për angazhimin e stafit akademik me gradën Doktor për vitin akademik 2023-2024 është një hap pozitiv dhe i domosdoshëm drejt rritjes së cilësisë. Megjithatë, është e rëndësishme që universiteti të vazhdojë të monitorojë dhe vlerësojë procesin e angazhimit të stafit, për të siguruar që standardet e larta të mbahen në çdo fazë të programit. Kjo do të ndihmojë jo vetëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, por gjithashtu do të rrisë besueshmërinë e programit.**



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteret</b>	
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” i ofruar nga Albanian University synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare duke formuar profesionistë të ardhshëm të shëndetit mendor në përputhje me nevojat e komunitetit për këtë shërbim. Në këtë kuadër profesionistët e ardhshëm, të formuar përmes këtij programi, japin një kontribut në rritjen e cilësisë së jetës në vendin tonë duke adresuar nevojat kombëtare në këtë drejtim.</p> <p><i>Evidenca 1.2. Statuti Albanian University;</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Përgjithshme e Albanian University;</i> <i>Evidenca H1. Rregullore e Programit të Studimit MSH Psikologji Klinike</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është në përputhje me misionin dhe vizionin e Albanian University, sikundër parashtrohet në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit, për të formësuar profesionistë të denjë në shërbim të komunitetit. Fusha e veprimtarisë së institucionit ka përfshirë prej fillimeve të veta Psikologjinë e përgjithshme si një drejtim kryesor akademik. Programi përkatës Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” ngrihet mbi programin Bachelor dhe ka qenë aktiv prej 14 vitesh tashmë.</p> <p><i>Evidenca 1.2. Statuti Albanian University;</i> <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Përgjithshme e Albanian University;</i> <i>Evidenca H1. Rregullore e Programit të Studimit MSH Psikologji Klinike</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi MSH në Psikologji Klinike ofrohet në zbatim të Strategjisë për Zhvillim të Institucionit (2017-2022 dhe 2023-2028) për të formuar profesionistë në fushën e shkencave sociale, të pajisur me njohuri shkencore dhe në shërbim të komunitetit. Si Statuti dhe Rregullorja e Institucionit përfshijnë Psikologjinë si një nga drejtimet kryesore akademike, me të dy ciklet e studimit Bachelor dhe Master.</p> <p><i>Evidenca 1.2. Statuti Albanian University; Evidenca 1.3. Rregullore e Përgjithshme e Albanian University; Evidenca 1.4.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; Evidenca 1.4.b Strategjia e Zhvillimit Institucional 2023-2028</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është në përputhje me strategjitë kombëtare për zhvillim duke formësuar profesionistë të aftë në shërbim të komunitetit. Programi gjithashtu reflekton qartësisht prirjet globale të zhvillimit, drejt adresimit të çështjeve të shëndetit mendor, dhe terapive përkatëse me synim përmirësimin e cilësisë së jetës të pacientëve me çrregullime psikologjike.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” ofrohet në përputhje me interesat dhe vlerat kombëtare, fushën e veprimtarisë së institucionit si dhe prirjet globale, duke formësuar profesionistë të shëndetit mendor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b></p>	
<p><b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është ofruar nga Albanian University për një periudhë 14 vjecare cka demonstroi se institucioni ka përvojën e duhur në ofrimin e këtij programi. Infrastruktura e universitetit dhe burimet njerëzore konsiderohen gjithashtu të përshtatshme për ofrimin e këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidenca 4.2. Cv e stafit akademik</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është Fakulteti i Shkencave Shoqërore i cili përbëhet nga 3 njësi bazë: Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, dhe Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes. Programi Master Shkencor në “Psikologji Klinike” ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane. Sipas ISCED-F (International Standard Classification of Education) (2013) fusha e programit klasifikohet nën kategorinë 03 – Social sciences, journalism and information.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore; International Standard Classification of Education (ISCED-F, 2013)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi Master Shkencor në “Psikologji Klinike” ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të kësaj njësie si dhe direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane në lidhje me programet e studimit. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ofron programin Bachelor në Psikologji si dhe Programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike.</p> <p><i>Evidenca H1. Rregullore e Programit të Studimit MSH Psikologji Klinike</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni ndjek studentët e diplomuar edhe pas mbarimit të studimeve përmes zyrës së Karrierës dhe Alumni. <i>Gjithsesi në mes të aktiviteteve të ndryshme organizuar për studentët e diplomuar mungojnë trajnimet profesionale në bashkërendim me punëdhënësit.</i></p> <p><i>Evidenca 5.10 Rregullore Zyra e Karrierës dhe Alumni</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Institucioni duhet të angazhohet më tepër në drejtim të</i></p>

	<i>trajnimeve profesionale për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme bashkëpunon me Zyrën e Kurrikulave, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe Njësinë e Kërkimit Shkencor për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Gjithashtu struktura të tjera me karakter administrativ si Sekretaria apo Zyra e Burimeve Njerëzore gjithashtu bashkëpunojnë ngushtësisht me departamentin për të siguruar mbarëvajtjen e programit të studimit. Secila struktur është e ndar dhe përcaktuar në detyra dhe përgjegjësi si në statut ashtu edhe në rregulloret përkatëse, dhe bashkëpunimi mes tyre është i frytshëm në shërbim të studimit. Secila</p> <p><i>Evidenca 2.2. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme; Evidenca 6.9. Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Evidenca 4.6. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në kuadër edhe të plotësisht të rekomandimit nga Bordi i Akreditimit Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, ka zgjeruar numrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me institucione homologe ose aktorë të tjerë. <b><i>Gjithsesi institucioni nuk ka paraqitur evidencë konkrete në lidhje me mënyrën sesi këto marrëveshje janë zbatuar në funksion të programit Master I Shkencave në “Psikologji Klinike” (psh., praktika profesionale, studime shkencore etj).</i></b> Raporti i dorëzuar është në nivel raportimi emrash dhe jo analize të mirëfilltë në funksion të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca R1a. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidenca 1.7. Raporti analitik I marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të programit të studimit ; Evidenca (shitesë) 23. Raporti analitik I praktikave në Msc. Psikologji Klinike.</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera si Center for Open Access in Science” në Beograd, “South-West University” në Bullgari, “The Institute for Advance Psychological Training” në SHBA, me “International Network of Psychotherapy Practice” në Angli, me “Tuf Medical Center” në SHBA, “Sigmund Freud University” në Vjenë etj. Nga takimet gjatë vizitës u konstatua se përmes këtyre marrëveshjeve është realizuar kryesisht mobiliteti i stafit akademik dhe në raste të rralla edhe i studentëve. <i>Gjithsesi mungon një raport analitik në nivel programi studimi mbi mënyrën sesi këto marrëveshje zbatohen qartësisht në funksion të programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike.</i></p> <p><i>Evidenca R1a. Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidenca (shtesë) 23. Raporti analitik I praktikave në Msc. Psikologji Klinike.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p><i>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme nuk ka hartuar një raport analitik për marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”. Lista e objektivave të Praktikës Profesionale apo Institucioneve ku realizohet kjo praktikë është e pamjaftueshme për analizën e domosdoshme në lidhje me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit specifikisht në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 1.7. Raporti analitik i marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të programit të studimit ; Evidenca (shtesë) 23. Raporti analitik i praktikave në Msc. Psikologji Klinike.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me palë të treta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjithsesi mungon evidenca në formën e raporteve analitike për zbatimin e këtyre marrëveshjeve në funksion të realizimit të programit të studimit, psh., aftësimi profesional, kërkimi shkencor, mobiliteti etj.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> <p>X</p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
--	--	-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është organizuar në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Veprimtaritë formuese të programit A-E janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë si dhe VKM 41. Secilin vit akademik student grumbullon 60 ECTS.</p> <p><i>Evidenca 2.1a Kurrikula e Programit të Studimit Msc Psikologji Klinike; Evidenca H.1 Rregullore e Programit të Studimit Msc në Psikologji Klinike</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” thellohet përtej njohurive të dhëna në programin e ciklit të parë Bachelor në Psikologji të Përgjithshme duke u fokusuar në fushën e Psikologjisë Klinike. Programi kombinon njohuritë e avancuara teorike në profesion me metodologjinë e kërkimit shkencor si dhe aftësimin praktik të studentit për të vlerësuar raste klinike. Në këtë mënyrë studentët fitojnë njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse me të cilat mund të përballen më tej në jetën e tyre profesionale.</p> <p><i>Evidenca 2.1a Kurrikula e Programit të Studimit Msc Psikologji Klinike; Evidenca H.1 Rregullore e Programit të Studimit Msc në Psikologji Klinike</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e</p>	<p>Ngarkesa në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe tezës së diplomës është në përputhje me VKM nr.41, datë 24.01.2018, përkatësisht Praktika profesionale: 6 ECTS (5%) dhe</p>

praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Teza e diplomës: 18 ECTS (15%). <i>Evidenca 2.1a Kurrikula e programit Msc në Psikologji Klinike</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N/A
<b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N/A
<b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në	N/A

kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.									
<b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në “Albanian University” ofron 3 programe studimi në ciklin e dytë: 1 program Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” dhe 2 programe Master Profesional në “Psikologji Shkollore” dhe “Psikologji Klinike”. Programi Master Profesional në Psikologji Klinike është me 60 ECTS, dhe është i ngjashëm me programin Master i Shkencave në Psikologji Klinike në masën 72% (ose 43 kredite në total).</p> <p><i>Evidenca 2.2. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme.</i></p>								
<b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	<p>Institucioni ka raportuar se është angazhuar në përgatitjen e kodifikimit në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr. 31, datë 15.11.2022 mbi kodifikimin e programeve të studimit. Ky është një proces që Akoma nuk ka mbaruar dhe të gjithë institucionet e arsimit të lartë janë pritur të finalizimit.</p> <p><i>Evidenca: Shënime gjatë vizitës</i></p>								
<b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit.</p> <p><i>Evidenca H.1 Rregullore e Programit të Studimit Msc në Psikologji Klinike</i></p>								
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, në lidhje me strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, dhe numrin e krediteve.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është Fakulteti i Shkencave Shoqërore i cili përbëhet nga 3 njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative;</li> <li>- Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme;</li> <li>- Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes.</li> </ul> <p>Njësia bazë që ofron programin e studimit Master Shkencor në “Psikologji Klinike” është Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme. Njësia kryesore dhe ajo bazë përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për strukturën akademike. Albanian University përbëhet nga 3 Fakultete:</p> <p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore;</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore;</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.</p> <p>Stafi i departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme ndër vite ka pasur shpërndarjen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 2020-2021 7 PAE (1 Prof. Asoc, 4 Dr, 1 SPA, 1 Msc) dhe 11 PAK (2 Prof. Dr, 1 Prof. Asoc., 4 Dr, 4 Msc);</li> <li>- 2021-2022 8 PAE (1 Prof. Asoc, 4 Dr, 1 SPA; 2 Msc) dhe 11 PAK (2 Prof. Asoc, 5 Dr; 4 Msc)</li> <li>- 2022-2023 9 PAE (1 Prof. Asoc, 5 Dr, 1 SPA, 2 Msc) dhe 14 PAK(3 Prof. Asoc.; 5 Dr; 6 Msc)</li> </ul> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore; Evidenca 2.2. Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme cakton një pedagog përgjegjës për mbikqyrjen e praktikave mësimore të cilat zhvillohen në institucionet me të cilat “Albanian University” ka marrëveshje bashkëpunimi si Instituti i nxënësve që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë, Qendra për Shërbime psikologjike të integruara, Qendra Equilibrium, Qendra Johnatan etj.</p> <p><i>Evidenca shitesë: Evidenca për praktikat profesionale.</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit ka emëruar një anëtar të brendshëm të departamentit në rolin e koordinatorit të programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”.</p> <p><i>Evidenca shitesë: Koordinatori i Programit të Studimit të Departamentit të Psikologjisë</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë, përfshi strukturën akademike, zhvillimin e praktikave profesionale dhe koordinatorin e programit të studimit. Njësia kryesore dhe ajo bazë përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për strukturën akademike</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.3</b></p>	
<p><b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” përfshi kurrikulën, planin mësimor, dhe syllabuset në shqip dhe anglisht të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca: Syllabuset (Dok. 23-42); Evidenca 2.1.a Kurrikula e programit te studimit MSc. ne Psikologji Klinike</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të</p>	<p>Plani mësimor për programin Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” është i ndarë në semestra dhe përmban ngarkesën mësimore të detajuar brënda dhe jashtë auditorit, 1500 orë në vit/3000 orë Format e mësimdhënies në auditor janë 601 ore ne total 240orë, Leksione, 120 orë Seminare, 98 orë Laboratorë</p> <p><i>Evidenca 2.1.a Kurrikula e programit te studimit MSc. ne Psikologji Klinike</i></p>

lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.									
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Rregullorja e “Regjistrimeve dhe transferimeve” në nivel institucional përmban kriteret e përgjithshme të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. <i>GVJ evidentoi se mungojnë kriteret specifike për pranimin në programin e studimeve Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”.</i>  <i>Evidenca 2.5 Rregullore e Zyres se Regjistrimeve dhe Transferimeve</i>								
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programe lëndore ndjekin një format standard që përfshin informacion mbi ngarkesën mësimore, tematikat specifike për çdo javë dhe format e vlerësimit. <i>Gjithsesi gjatë rishikimit të syllabuseve u konstatua se mungon përfshirja e rezultateve të të nxënit.</i>  <i>Evidenca: Syllabuset (Dok. 23-42)</i>								
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Institucioni ka një procedurë në Rregullore mbi përditësimin e programeve të studimit përgjatë çdo viti akademik. <i>Në lidhje me programin specifik të studimit nuk u paraqit evidencë në lidhje me përditësim apo ndryshime në syllabuset e lëndëve (arkiva të dosjeve të programit të studimit në shqip dhe anglisht). Gjithashtu literatura tepër e vjetër (mbi 10 vite) e përfshirë në syllabuse dëshmon nevojën e përditësimin në programin specifik të studimit.</i>  <i>Evidenca H.1 Rregullore e Programit të Studimit Msc në Psikologji Klinike; Evidenca: Syllabuset (Dok. 23-42)</i>								
<b>Konkluzione</b>	<i>Njësia bazë disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”. Gjithsesi u konstatua se nevojitet përditësim i këtij programi sa i takon përmbajtjes së syllabuseve dhe literaturës përkatëse.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” mundëson thellimin e njohurive të marra në nivelin Bachelor, duke kanalizuar studentët drejt aspektit klinik të fushës së psikologjisë. Gjithashtu ky program aftëson studentët për studime të mëtejshme të ciklit të tretë, duke ofruar njohuri të avancuara në metodologjinë sasiore dhe atë cilësore të kërkimit shkencor. Programi respekton ndarjen në përqindje të veprimtarive formuese A-E, specifikuat, kategoria A-10%, kategoria B, 50.8%; Kategoria C 14.2%, Kategoria D 10%, Kategoria E, 15%. <i>Gjithsesi konstatohet se lëndët me karakter metodologjik (Metodat cilësore dhe sasiore) janë klasifikuar në kategorinë B dhe jo A.</i></p> <p><i>Evidenca 2.1.a Kurrikula e programit të studimit MSc. në Psikologji Klinike</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve nëpër semestra mundëson arritjen e objektivave formues të programit duke e drejtuar studentin gradualisht nga lëndë të përgjithshme (psh Viti1: Psikologjia e zhvillimit e avancuar) drejt atyre me karakter të mirëfilltë klinik (psh., Viti 2: Psikopatologjia e Zhvillimit). Modulet e Metodave të Kërkimit Shkencor gjithashtu përmbillen në vitin e parë, duke hedhur baza solide për dizenjimin e temës së diplomës vitin e dytë.</p> <p><i>Evidenca 2.1.a Kurrikula e programit të studimit MSc. në Psikologji Klinike</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Struktura e programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” reflekton karakterin ‘shkencor’ të këtij programi, me thellimin e njohurive në kërkim shkencor dhe formim teorik në fushën e psikologjisë klinike. <i>Gjithsesi, përsa i takon aftësimin praktik krahas praktikës profesionale, kurrikula parashikon dhe modulën Intervistim/Praktikum prej 6 ECTS, në vitin e dytë të studimit i cili mundëson aplikimin praktik të njohurive teorike të marra. Në këtë aspekt ky program është i ngjashëm me programe të tjera ndërkombëtare ofruar në Psikologji Klinike, fakt ky që lehtëson mobilitetin e studentëve (programe Erasmus) apo transferimin e studimeve jashtë vendit.</i> Së fundmi, studentët e këtij programi, në përfundim të studimeve, janë aftësuar për të ndjekur të gjitha procedurat e parashikuara në legjislacion për licensimin në profesionin e psikologut, apo për të ndjekur më tej studime të ciklit të tretë (doktoratë) në fushën përkatëse studimore.</p> <p><i>Evidenca 2.1.a Kurrikula e programit të studimit MSc. në Psikologji Klinike; Syllabusët: Intervistim/Praktikum</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p><i>Syllabusët e lëndëve nuk janë përditësuar në nivelin e duhur, sidomos përsa i takon literaturës së përdorur (si bazë dhe ndihmëse) e cila është e vjetër mbi një dekadë në disa raste. Disa shembuj ku literatura e detyrueshme shtrihet në intervalin nga 10 deri 20 vite vjetërsi përfshijnë: Psikologji Klinike, Psikopatologjia e Adoleshentëve, Ndërhyrje në Raste Krizash dhe Traumash, Terapia Familjare, Vlerësimi Psikologjik etj. Gjithashtu nga shqyrtimi i syllabuseve konstatohet se mungojnë rezultatet e të nxënësve, duke u mjaftuar vetëm me një përmbledhje apo përshkrim të modulit/lëndës.</i></p> <p><i>Evidenca: Syllabusët (Dok. 23-42)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” pajis studentët me njohuri të thelluara në fushën e psikologjisë klinike, si dhe aftësi e kompetenca për vlerësimin/ diagnostikimin e rasteve klinike dhe trajtimin e tyre përmes terapisë individuale dhe në grup. Gjithashtu praktika profesionale e supervizuar, lejon fitimin e kompetencave për të punuar në këtë profesion në të ardhmen në kontekste të ndryshme si klinika, spitale, etj. Së fundmi punimi i diplomës, nën udhëheqjen e pedagogut përkatës i mundëson studentëve fitimin e aftësive dhe kompetencave për punë kërkimore shkencore të mirëfilltë, duke lehtësuar vazhdimin drejt</p>

	ciklit të tretë të studimeve (doktoratë).			
	<i>Evidenca 2.1.a Kurrikula e programit te studimit MSc. ne Psikologji Klinike</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara nga studentët e këtij programi për vlerësimin/ diagnostikimin e rasteve klinike dhe trajtimin e tyre përmes terapisë individuale dhe në grup, i lejojnë studentët e diplomuar të ndjekin të gjitha procedurat e parashikuara në legjislacion për licensimin në profesionin e psikologut. Formimi në metodologjitë e kërkimit shkencor dhe aftësimi për punë të pavarur kërkimore (përmes punimit të diplomës) gjithashtu ju mundëson ndjekjen më tej të studimeve të ciklit të tretë (doktoratë) në fushën përkatëse studimore.			
	<i>Evidenca 2.1a Kurrikula e programit Msc në Psikologji Klinike; Evidenca Syllabuset, shemb. Metodat sasiore të kërkimit shkencor/Metodat cilësore të kërkimit shkencor/Terapia e grupit/Terapia Familjare</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” mundëson thellimin e njohurive të marra në nivelin Bachelor, duke kanalizuar studentët drejt aspektit klinik të fushës së psikologjisë, dhe lejuar ndjekjen e procedurave të mëtejshme për licensim në profesion apo ndjekjen e ciklit të tretë të studimeve. Në funksion të rritjes së cilësisë së programit këshillohet rishikim i syllabuseve me qëllim përditësimin e tyre me literaturën e viteve të fundit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e	<i>Institucioni nuk paraqiti evidencë në lidhje me propozime konkrete nga institucione partnere apo aktorë të tjerë nga tregu i punës në lidhje me programin Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”. Gjatë vizitës në institucion gjithashtu nuk u paraqit evidencë shtesë në lidhje me procedura konkrete të ndjekura për përmirësimin e këtij programi studimi në përputhje me nevojat e tregut.</i>  <i>Evidenca: Shënime gjatë vizitës.</i>

institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.									
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni disponon politika në lidhje me përfshirjen e studentëve në procese konsultuese dhe vendim-marrëse (psh., mbledhjet e Departamentit, apo Senatit Akademik), si dhe përmes aktiviteteve me studentët e diplomuar (Alumni). <i>Gjithsesi në lidhje me programin specifik të studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” nuk u paraqitën shembuj konkretë mbi rolin e studentëve apo alumni në përmirësimin e këtij programi studimi.</i>  <i>Evidenca 5.10. Rregullore Zyra e Karrierës dhe Alumni; Evidenca 1.3. Rregullore e Përgjithshme e Albanian University</i>								
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Institucioni mban kontakte me Urdhrin e Psikologut të Republikës së Shqipërisë, duke organizuar takime me përfaqësues të këtij institucioni, në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Gjithsesi nevojitet një angazhim në shkallë më të gjerë me përfshirjen e aktorëve nga institucione të tjera publike e jo-publike, për të marrë një feedback të vazhdueshëm në lidhje me përmirësimin e programeve të studimit.  <i>Evidenca: Rregullore për regjistrimin, anëtarësimin dhe licensimin në Urdhërin e Psikologut të Republikës së Shqipërisë.</i>								
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni ka politika për përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Gjithsesi nevojiten më tepër përpjekje në lidhje me përfshirjen e këtyre aktorëve në procese konkrete me rezultate specifike dhe të matshme.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë	Programi i studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” ka të përcaktuar në rregulloren e vet objektivat e kërkimit shkencor, në linjë me objektivat për kërkim-zhvillim të institucionit. Studentët e

<p>prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>këtij programi marrin njohuri të avancuara të kërkimit shkencor përmes moduleve përkatëse, angazhohen në projekte të kërkim-zhvillimit, apo konferenca të organizuara nga institucioni si dhe përmbyllin studimet me punimin e diplomës me karakter të mirëfilltë kërkimor-shkencor.</p> <p><i>Evidenca H.1 Rregullore e programit të studimit MSc. në Psikologji Klinike; Evidenca 1.4.a Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022; Evidenca 1.4.b Strategjia e Zhvillimit Institucional 2023-2028</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme administron dhe koordinon veprimtaritë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor (psh. konferenca), në respekt të lirisë akademike të pedagogëve. <b><i>Gjithsesi u konstatua nga takimi me pedagogët por edhe anëtarët e Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, se departamenti duhet të angazhohet më tepër në nxitjen dhe mbështetjen e aktivitetit të kërkimit shkencor. Ky funksion po ushtrohet kryesisht nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit e cila operon në nivel Institucional.</i></b></p> <p><i>Evidenca: Shënime gjatë vizitës. Evidenca shtesë: Rregullore e Zyres së Koordinimit dhe Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Studentët e programit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” angazhohen në aktivitete kërkimore si Konferenca studentore apo publikime në bashkëpunim me pedagogët në revistën e universitetit “Optime”. Gjatë takimit me studentët u përmendën shembuj konkretë të këtyre angazhimeve.</p> <p><i>Evidenca shtesë: Post-pandemic Challenges in Psychology and Education - VILMA RUCI; Evidenca 2.10a/2.10b/2.10.c Axhenda Konferenca I studentore/Konferenca II studentore</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Institucioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në lidhje me mbështetjen financiare të kërkimit shkencor përmes Granteve për publikime shkencore në revista me faktor impakti apo financimit të konferencave shkencore ndërkombëtare. Gjatë takimit me Njësinë e Kërkimit shkencor si dhe takimit me pedagogët u përmendën shembuj konkretë të mbështetjes financiare të pedagogëve për të realizuar aktivitetin e tyre kërkimor-shkencor.</p> <p><i>Evidenca: Shënimet gjatë vizitës-takimi me pedagogët</i> <i>Evidenca shtesë: Evidencë për shumën e fondit të kërkimit shkencor.</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Institucioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm konkretë për mbështetjen financiare të kërkimit shkencor të pedagogëve si dhe përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor</i></p>

	<i>përmes organizimit të konferencave apo botimeve në revistën "Optime".</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Institucioni ka politika të mirëpërcaktuara që diktojnë format e bashkëpunimit të Departamenteve me Njësinë e Kërkimit në funksion të realizimit të objektivave të kërkimit shkencor. Institucioni mbështet financiarisht pjesëmarrjen në konferenca shkencore apo publikimet në revista me faktor impakti si dhe nxit pjesëmarrjen e stafit në projekte shkencore sipas fushës së specialitetit. Në kuadër të Programit të Studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike u evidentuan 2 forma kryesore përfshi: Pjesëmarrjen e studentëve të këtij programi në konferencën studentore dhe publikim në bashkëautorësi në revistën Optime.</p> <p><i>Evidenca 2.10a/2.10b/2.10.c Axhenda Konferenca I studentore/Konferenca II studentore</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	<p>Departamenti Psikologjisë së Përgjithshme bashkëpunon ngushtësisht me Njësinë e Kërkimit duke ju përgjigjur kërkesave të tyre për staf të specializuar në përputhje me nevojat e projekteve të ndryshme kërkimore. Studentët gjithashtu janë përfshirë së fundmi në projekte të inciuara nga kjo njësi, sipas profileve përkatëse.</p> <p><i>Evidenca shtesë: Rregullore e Zyrës së koordinimit dhe kërkimit shkencor dhe botimeve; Evidenca shtesë: Revista_Konferenca</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	<p>Aktiviteti kërkimor në fushën e programit të studimit, realizohet përmes bashkëpunimit në nivel Fakulteti apo Institucioni; psh., konferenca studentore në bashkëpunim me Departamentin e Anglishtes dhe Edukimit. Ndërkohë Departamenti inicion aktivitete më të vogla si leksione të hapura, ëorkshope etj.</p> <p><i>Evidenca 2.10a/2.10b/2.10.c Axhenda Konferenca I studentore/Konferenca II studentore; Evidenca shtesë: Revista Konferenca</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për	<p>Programi studimit Master Shkencor në "Psikologji Klinike" formon profesionistë të fushës me aftësitë dhe kompetencat e duhura për tu përballur me tregun e punës në Shqipëri. Periudha e të dhënave</p>



tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	2019-2020 tregun se nga 45 te diplomuar , 25 janë punësuar ,ne përputhje me diplomen, 20 jashtë diplomës. <i>Gjithsesi nevojitet një përditësim më gjithëpërfshirës i syllabuseve dhe literaturës përkatëse në mënyrë që studentët të jenë profesionistë konkurrues edhe ndërkombëtarisht.</i>			
	<i>Evidenca: Syllabuset e Programit të Studimit (Dok. 23-42)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Urdhrin e Psikologut, sikundër tregohet në evidencën e vizitave nga përfaqësues të Urdhrit në Institucion, për të vënë në dijeni mbi të rejat apo rekomandimet më të fundit për licensimin në këtë profesion.			
	<i>Evidenca 1.1.a Raport Vjetor i Departamentit të psikologjisë së Përgjithshme - v.a 2021-2022; Rregullore për regjistrimin, anëtarësimin dhe licensimin në Urdhërin e Psikologut të Republikës së Shqipërisë.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	Programi i studimit përputhet me aktet ligjore në vend për Profesionin e Rregulluar të Psikologut në Republikën e Shqipërisë duke mundësuar studentët që përfundojnë këtë program studimi të ndjekin procedurat e parashikuara për Licensim në këtë profesion.			
	<i>Evidenca: Rregullore për regjistrimin, anëtarësimin dhe licensimin në Urdhërin e Psikologut të Republikës së Shqipërisë.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni ka politika të mirëpërcaktuara që diktojnë format e bashkëpunimit të Departamenteve me Njësinë e Kërkimit në funksion të realizimit të objektivave të kërkimit shkencor. Departamenti bashkëpunon ngushtësisht me Urdhrin e Psikologut të Shqipërisë duke lehtësuar integrimin e studentëve në tregun e punës. Në mënyrë që studentët të jenë konkurrues jo vetëm në nivel kombëtar por edhe ndërkombëtar nevojitet një përditësim i programit dhe syllabuseve me zhvillimet/literaturën më të fundit të fushës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i syllabuseve të programit tëstudimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” u konstatua se pedagogët përdorin këto forma të mësimdhënies: leksione, seminare/ushtrime, detyra kursi, dhe praktikë mësimore. Gjithashtu gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët u evidentua se departamenti organizon leksione të hapura me profesionistë të fushës për studentët e këtij programi studimi.  <i>Evidenca: Syllabusët; Shënimet gjatë vizitës: takimi me stafin/studentët; Evidenca 5.6. Si të punosh; Evidenca 5.7. Si të menaxhoni stresin</i>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Gjatë takimeve me stafin dhe studentët u raportua se stafi akademik përdor një larmishmëri metodash në mësimdhënie, përfshi punën në grupe të vogla, analiza rastesh studimore, role-play, vizita studimore etj., duke ju përgjigjur kështu nevojave të ndryshme të studentëve.  <i>Evidenca: Shënime gjatë vizitës: Takimi me stafin/studentët.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni mbështet stafin akademik në përmirësimin e aftësive didaktike. Kështu gjatë periudhës së pandemisë stafi akademik mori trajnim të specializuar në lidhje me mësimdhënien online, për të siguruar cilësinë e mësimdhënies edhe në mediumin online. Gjithashtu po në këtë funksion, Institucioni ka hartuar udhëzues për platforma në ndihmë të mësimdhënies (si platforma Teams), të cilat shërbejnë më së miri edhe pas rikthimit në auditore.  <i>Evidenca 3.5.a Manual për realizimin e mësimin online 2020-2021; Evidenca 3.5b. Manual I Provimeve online 2020-2021; Evidenca 3.5.c Udhëzues video për përdorimin e platformës Microsoft Teams.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” përdor

<p>në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>metoda të ndryshme interaktive me në qendër studentin përfshi fokus-grupin, role-play, debate të simuluara, diskutime bazuar në material audio-vizuale, punë në grupe të vogla etj. Në këtë mënyrë nxitet mendimi krijues tek studentët, aftësitë bashkëvepruese, dhe autonomia në procesin e të nxënit. Në cdo rast, pedagogu përkatës siguron mbështetjen dhe udhëheqjen e tij në proces sipas nevojës duke siguruar mbarëvajtjen dhe realizimin e objektivave të të nxënit. Kjo qasje u konfirmua nga studentët gjatë vizitës.</p> <p><i>Evidenca: Shënime gjatë vizitës: Takimi me stafin/studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni monitoron dhe vlerëson format dhe metodat e mësimdhënies duke përfshirë studentët në këtë proces. Informacioni merret përmes pyetësorëve dhe fokus grupeve me studentët, ku ata japin feedback në lidhje me lëndët dhe pedagogët. Gjatë vizitës u kërkua një shembull konkret për programin specifik Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” për mënyrën sesi mendimet apo sugjerimet e studentëve trajtohen.</p> <p><i>Evidenca është dorëzuar, por ngelet në nivelin e një dokumenti “Kthim përgjigje” dhe jo trajtim/analizë më të thellë të situatës.</i></p> <p><i>Evidenca shitesë: Fokus grupet-kthim përgjigje 2018-2019; Fokus grupet-kthim përgjigje 2021-2022.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për</p>	<p>Në nivel institucional, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, janë 2 njësitë përgjegjëse për promovimin e cilësisë së mësimdhënies, në formë dhe përmbajtje. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë angazhohet në vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies përmes pyetësorit të studentëve dhe fokus grupeve; raportet përkatëse i përcillen njësisë bazë për shqyrtim dhe veprim të mëtejshëm. Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave asiston Departamentin në lidhje me nevojën për ndryshime përmbajtësore sërish në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Institucioni paraqiti shembuj për trajnimet e stafit përgjatë viteve 2018-2023.</p> <p><i>Evidenca 6.6 Rregullore për mbarëvajtjen e Kurrikulave dhe Procesit Mësimor në Albanian University;</i>  <i>Evidenca 6.4. Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në Albanian University;</i>  <i>Evidenca 3.1a/3.1b/3.1c/3.1d.</i>  <i>Evidenca për trajnimet e stafit 2018-2019;2019-2020;2020-2021;2021-2022;2022-2023.</i></p>

përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.				
<b>Konkluzione</b>	<i>Stafi akademik përdor një larmishmëri metodash në mësimdhënie, përfshi punën në grupe të vogla, analiza rastesh studimore, role-play, vizita studimore etj., duke ju përgjigjur kështu nevojave të ndryshme të studentëve. Në nivel institucional, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, janë 2 njësitë përgjegjëse për promovimin e cilësisë së mësimdhënies, në formë dhe përmbajtje.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e Programit të Studimit si dhe cdo syllabus përfshin kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Si nga kontrolli i syllabuseve, edhe nga takimet me pedagogët dhe studentët u konstatua se vlerësimi mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të <ul style="list-style-type: none"> <li>A. Provimit përfundimtar, i cili mbart 60% të peshës në vlerësim</li> <li>B. Provimit të ndërmjetëm, i cili mbart 20% të peshës dhe</li> <li>C. Pjesëmarrja aktive në seminare, detyra/projekte kursi, që mbart gjithashtu 20% të peshës në vlerësim.</li> </ul> <p><i>Evidenca: Syllabuset (Dok. 23-42)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjatë takimeve me stafin dhe studentët, u konfirmua se në fillim të çdo lënde/moduli, studentët njihen me format e vlerësimit që në orët e para të mësimin përmes prezantimit të syllabusit të lëndës. Specifikime në përputhje me përmbajtjen e çdo lënde përfshi tematikat e çdo jave, literaturën etj., jepen në syllabuset përkatëse të cilat vihen në dispozicion të studentëve. <p><i>Shënimet gjatë vizitës: Takim me studentët</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Si stafi dhe studentët konfirmuan se vlerësimi mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është

profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	rezultat i kombinimit të elementeve që përmendëm më sipër. Në këtë mënyrë studenti ka mundësinë të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në forma dhe mënyra të ndryshme, duke dhënë një vlerësim më të plotë dhe objektiv.  <i>Evidenca: Syllabuset (Dok. 23-42); Shënimet gjatë vizitës: Takime me studentët/stafin</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Rregullorja e Programit të Studimit si dhe cdo syllabus përfshin kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimin të njohurive bazuar mbi parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të Provimit përfundimtar- 60%, Provimit të ndërmjetëm-20% dhe pjesëmarrjes në seminare, detyra/projekte kursi-20%.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Rregullorja e Programit të Studimit si dhe cdo syllabus përfshin kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimin të njohurive. Vlerësimi mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të a. Provimit përfundimtar, i cili mbart 60% të peshës në vlerësim b. Provimit të ndërmjetëm, i cili mbart 20% të peshës dhe c. Pjesëmarrja aktive në seminare, detyra/projekte kursi, që mbart gjithashtu 20% të peshës në vlerësim.  <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Përgjithshme e Albanian University; Evidenca H1. Rregullore e Programit të Studimit MSH Psikologji Klinike</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni nuk përdor sisteme elektronike të testimit, por përdor sekretimin e tezave (dhe csekretimin vetëm pas korigjimit) të provimit si formë për të shmangur abuzimin dhe rritur transparencën e vlerësimin.  <i>Evidenca 4.6. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>

<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i secilës lëndë parashikohet në syllabuset përkatëse dhe bazohet në përlogaritjen e peshës së pikëve të marra në: provimin përfundimtar (60%), provimin e ndërmjetëm (20%), dhe pikët e seminareve/detyra kursi (20%).</p> <p><i>Evidenca: Syllabuset (Dok. 23-42)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë takimeve me pedagogët dhe studentët u konfirmua se feedback-u në lidhje me provimet është një procedurë që vihet konkretisht në zbatim. Pra pedagogët diskutojnë me studentët në auditor tezën e provimit, dhe celësin përkatës, duke evidentuar edhe problematika që mund të jenë konstatuar gjatë vlerësimit. Në këtë mënyrë studenti vëren në mënyrë transparente procesin e korrigjimit cka e ndihmon për përmirësim në vlerësimet e tjera në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca: Shënime gjatë vizitës në institucion.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Rregullorja e Institucionit dhe Programit të studimit parashikon një procedurë të qartë në lidhje me shmangien e plagjiaturës/kopjimit në provime dhe detyra kursi. Gjatë takimit me studentët ata treguan dijeni në lidhje me seriozitetin e kësaj çështje. <b><i>Gjithsesi institucioni nuk disponon një sistem elektronik për kontrollin e plagjiaturës, cka do të ishte e nevojshme sidomos në kontrollin e temave të diplomave.</i></b></p> <p><i>Evidenca 1.3. Rregullore e Përgjithshme e Albanian University; Evidenca H1. Rregullore e Programit të Studimit MSH Psikologji Klinike</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sikundër përcaktohet në Rregulloren e Programit të Studimit, nota përfundimtare bazohet mbi vlerësimin e vazhduar është rezultat i kombinimit të vlerësimit të provimit të ndërmjetëm, provimit përfundimtar, angazhimit të studentit në seminare, si dhe cilësia e detyrës së kursit të dorëzuar për lëndë. Staf i akademik ka një afat 7 ditor për vlerësimin dhe paraqitjen e rezultateve pranë sekretarisë mësimore; studentët bëhen me dije për vlerësimin përmes sistemit elektronik Pitagora në mënyrë individuale.</p> <p><i>Evidenca H1. Rregullore e Programit të Studimit MSH Psikologji Klinike</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në</p>	<p>Rregullorja e Institucionit dhe ajo e programit të studimit Master i Shkencave në "Psikologji Klinike" përcakton qartë të drejtën e studentit për tu njohur me vlerësimin, si dhe të drejtën për ankimim duke kryer kërkesë për rishikim vlerësimi. Gjatë takimit me studentët u konstatua se ata ishin në dijeni të plotë për këto të drejta, pavarësisht se pranuan se nuk kishte raste konkrete ankimimi për programin specifik të studimit. Institucioni</p>

statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	gjithashtu disponon një format të posaçëm për ankimimin e tezës.  <i>Evidenca 3.6. Format kërkesë për rishikimin e tezës</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas parashikimeve në Rregulloren e AU, pas kërkesës për rishikim të provimit nga ana e studentit, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një komision ad hoc për rishqyrtimin e tezës. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkëlidhet proces-verbalit të provimit (fletës së provimit). Gjatë takimit me pedagogët dhe studentët u konstatua se ata ishin në dijeni të procedurës, pavarësisht se pranuan se nuk kishte raste konkrete ankimimi për programin specifik të studimit.  <i>Evidenca 1.3. Rregullore e Përgjithshme e Albanian University; Evidenca H1. Rregullore e Programit të Studimit MSH Psikologji Klinike; Evidenca 4.6. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Rregullorja e institucionit përcakton qartë procedurat e ndjekura për vlerësimin e vazhduar të studentit, vënien në dijeni për rezultatet, dhe shqyrtimin e kërkesave për rivlerësim nga ana e studentëve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Përmbajtja e programit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” pajis studentët me njohuri të thelluara në fushën e psikologjisë klinike, si dhe aftësi e kompetenca për vlerësimin/diagnostikimin e rasteve klinike dhe trajtimin e tyre përmes terapisë individuale dhe në grup. Gjithashtu praktika profesionale e supervizuar, lejon fitimin e kompetencave për të punuar në këtë profesion në të ardhmen në kontekste të ndryshme si klinika, spitale, etj. Së fundmi punimi i diplomës, nën udhëheqjen e pedagogut përkatës i mundëson studentëve fitimin e aftësive dhe kompetencave për punë kërkimore shkencore të mirëfilltë, duke lehtësuar vazhdimin drejt ciklit të tretë të studimeve (doktoratë).  <i>Evidenca 2.1a Kurrikula e programit Msc në Psikologji Klinike; Evidenca Syllabuset, shemb. Metodatat sasiore të kërkimit</i>

	<i>shkencor/Metodat cilësore të kërkimit shkencor/Terapia e grupit/Terapia Familjare</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Si stafi akademik ashtu edhe studentët konfirmuan format e ndryshme të mësimdhënies. Shembuj përfshijnë punën në grupe, prezantimet, debatet apo role play nxisin zhvillimin e aftësive të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit.  <i>Evidenca: Shënime gjatë vizitës: Takimet me stafin dhe studentët.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të lëndës, stafi akademik harton raportin semestral, në të cilin raporton për realizimin e objektivave të mësimdhënies, përfshi fitimin e kompetencave apo aftësive të studentit si dhe vë në pah problematika të ndryshme që mund të jenë shfaqur. Gjithashtu gjatë orëve të fundit të mësimit, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar.  <i>Evidenca 1.1a Raport vjetor i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.1b Raport Semestri I Departamenti I Psikologjisë së Përgjithshme 2022-2023</i>
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese	Mësimdhënia në programin studimit Master i Shkencave në "Psikologji Klinike" ndërthur orët teorike të leksioneve me elementët praktikë gjatë seminareve (role-play, punë grupi, debate etj). Praktika mësimore e cila gjithashtu shtrihet përgjatë 1 semestri, dhe realizohet në bashkëpunim me institucionet partnere të Universitetit, pajis studentët me kompetenca profesionale, të cilat shërbejnë si bazë drejt profesionit të ardhshëm si psikolog klinik. Së fundmi, aftësimi në metodologjinë shkencore përmes moduleve përkatëse si dhe procesi përmes të cilit realizohet tema e diplomës pajis studentët me aftësitë e kompetencat e duhur për të ndjekur edhe ciklin e tretë të studimeve të doktoratës. Në këtë kuadër studentët gjithashtu nxiten për të marrë pjesë në aktivete shkencore si konferenca studentore, projekte apo për të botuar në Revistën Optime.  <i>Evidenca Syllabuset: Shemb. Metodat sasiore të kërkimit/Metodat cilësore të kërkimit/Praktika</i>



për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.									
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Departamenti paraqiti evidencë për organizimin e leksioneve të hapura me ekspertë të jashtëm, <i>por gjithsesi vlerësohet se duhen rritur përpjekjet në këtë drejtim sidomos përsa i takon aktiviteteve të organizuara në funksion të programit specifik të studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike”.</i></p> <p><i>Evidenca 5.6 Leksion I hapur Si të punosh</i> <i>Evidenca 5.7 Leksion i hapur Si të menaxhosh stresin</i></p>								
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	<p>Institucion paraqiti shembuj sesi studentët nxiten për të marrë pjesë në aktivete shkencore si konferenca studentore, projekte apo për të botuar në Revistën Optime në bashkëpunim me pedagogët e tyre. Në këtë drejtim institucioni po bën përpjekje të mira për të rritur shkallën e përfshirjes së studentëve në këto aktivitete, pavarësisht se ende nuk përfshihet mbështetja financiare.</p> <p><i>Evidenca 2.10a/2.10b/2.10.c Axhenda Konferenca I studentore/Konferenca II studentore</i></p>								
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” pajis studentët me aftësi e kompetenca për vlerësimin/ diagnostikimin e rasteve klinike dhe trajtimin e tyre përmes terapisë. Gjithashtu praktika profesionale e supervizuar, lejon fitimin e kompetencave për të punuar në këtë profesion në të ardhmen në kontekste të ndryshme si klinika, spitale, etj. Së fundmi institucioni nxit përfshirjen e studentëve në projekte e kërkim shkencor përmes pjesëmarrjes në konferenca studentore apo publikimit në Revistën Optime.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Psikologji Klinike” përcakton procedurën për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, përfshi afatet për paraqitjen e temës, miratimi i saj dhe caktimi i udhëheqësit shkencor etj. Rregullorja sëbashku me Manualin për hartimin e temës së diplomës vihet në dispozicion të studentëve.

	<p><i>Evidenca H1. Rregullore e Programit të Studimit Msc. Psikologji Klinike;</i>  <i>Evidenca 3.9b Manual i Punimit të Temës së Diplomës</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Institucioni asiston studentin në punimin e vet të diplomës përmes Manualit të Punimit të Temës së Diplomës si dhe udhëheqësit përkatës, i cili ndjek hap pas hapi mbledhjen e të dhënave për punimin kërkimor duke bashkëpunuar edhe me institucione të tjera ku mund të realizohet kjo procedurë.</p> <p><i>Evidenca 3.9b Manual i Punimit të Temës së Diplomës</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në pëputhje me Rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, udhëheqësi i temës së diplomës ka detyrimin për të ndjekur studentin gjatë gjithë periudhës së punimit të temës së diplomës. Ai udhëzon studentin në lidhje me përzgjedhjen e metodologjisë e përshtatshme për t'u përdorur, literaturën mbështetëse, shkrimin e tezës, prezantimin e saj etj. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton paraprakisht nëse punimi mund të paraqitet para komisionit për mbrojtjen e diplomës.</p> <p><i>Evidenca H1. Rregullore e Programit të Studimit Msc. Psikologji Klinike; Evidenca 3.9b Manual i Punimit të Temës së Diplomës</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni asiston studentin në punimin e vet të diplomës përmes Manualit të Punimit të Temës së Diplomës si dhe udhëheqësit përkatës, i cili ndjek hap pas hapi mbledhjen e të dhënave për punimin kërkimor duke bashkëpunuar edhe me institucione të tjera ku mund të realizohet kjo procedurë.</p> <p><i>Evidenca 3.9b Manual i Punimit të Temës së Diplomës</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sikundër parashikohet në Rregulloren e Programit të Studimit Master Shkencave në “Psikologji Klinike”, në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> <p><i>Evidenca H1. Rregullore e Programit të Studimit Msc. Psikologji Klinike</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve institucioni pajis studentin me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS. Me kërkesë të studentit përkatës institucioni vë në dispozicion edhe një kopje të plotë të programit të studimit të zhvilluar përgjatë dy viteve (përfshi syllabusët e lëndëve), të certifikuar nga Rektori i universitetit.</p> <p><i>Evidenca 3.10b. Model I Diplomës Msc. Psikologji Klinike; Evidenca 3.10c Suplementi i Diplomës Msc. Psikologji Klinike</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, të dhënat e studentëve të diplomuar ruhen si në formë fizike ashtu edhe elektronike, dhe vihen në dispozicion nëse kërkohen nga studentit apo struktura të tjera përkatëse.</p> <p><i>Evidenca 4.6. Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse, e cila përcaktohet në Rregulloren e Programit të Studimit. Studenti asistohet në çdo hap në realizimin e punimit të diplomës përmes Manualit përkatës si dhe kontaktit të ngushtë me udhëheqësin shkencor. Në përfundim të studimeve institucioni pajis studentin me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.6</b> Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose</p>	<p>N/A</p>

jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.									
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N/A								
<b>Kriteri 3.</b> Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N/A								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1

<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Personeli akademik PAE i angazhuar në realizimin e programit të studimit Master shkencor në “Psikologji klinike” përmbush kërkesa ligjore për nivelin e kualifikimit akademik. Secili pedagog mbulon lëndë të këtij cikli studimesh të cilat janë në përputhje me formimin dhe kualifikimin profesional të tij. Pothuajse i gjithë stafi akademik efektiv mbulon lëndë për të cilat ka ekspertizën profesionale. <i>Në seleksionimin e stafit akademik me kohë të pjesshme nuk janë aplikuar të njëjtat kriteret dhe standarde për të siguruar kështu një garanci në cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Një pjesë e personelit akademik me kohë të pjesshme (PAK) e angazhuar në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, rezultojnë të jetë me nivel MSc të kualifikimit.</i></p> <p>Stafi akademik përgjegjës për këtë program studimi ndër vite rezultojnë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2020-2021, 6 PAE (1 Prof. As, 4 Dr, 1 SPA) dhe 3 PAK (1 Prof. Dr, 1 Prof. As, 1 Dr);</li> <li>- Për vitin akademik 2021-2022, 5 PAE (1 Prof. As, 4 Dr, 1 SPA) dhe 3 PAK (1 Prof. As, 2 Dr);</li> <li>- Për vitin akademik 2022-2023, 6 PAE (2 Prof. As, 3 Dr, 1 SPA) dhe 4 PAK (1 Prof. As, 1 Dr, 1 SPA, 1 Msc).</li> </ul> <p>-</p> <p><i>Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore v.a 2018-2019</i>  <i>Evidenca 4.2 CV e stafit akademik dhe personelit ndihmes akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Ngarkesën mësimore për programin e studimit Master shkencor në “Psikologji klinike” në përputhje me kornizën ligjore në fuqi Viti akademik 2020-2021 tabela rezultojnë me 14 lende dhe PAE mbulon 52% ndersa PAK 48 %;</p> <p>Viti akademik 2021-2022 tabela rezultojnë me 20 lende dhe PAE mbulon 79.5 % ndersa PAK 20.5 %;</p> <p>Viti akademik 2022-2023 tabela rezultojnë me 19 lende dhe PAE mbulon 78% dhe PAK 22 %.. . Për punonjësit me kohë të plotë, kategoria profesor ka ngarkesën minimali me 140 orë në auditor, kategoria lektorë me 165 orë në auditorë dhe kategoria asistent-lektorë me 195 orë në auditorë. Asnjë pedagog nuk ka më shumë</p>

	<p>se 200 orë suplementare në auditor. Ndërsa personeli akademik me kohë të pjesshme i kategorisë lektor dhe asistent-lektorë ka maksimalisht 120 orë në auditor. Në ngarkesën vjetore të personelit akademik me kohë të plotë nuk ka më shumë se 3 lëndë semestrare në çdo semestër.</p> <p><b>GVJ rekomandon që AU të plotësojë kërkesat ligjore sipas VKM nr 418, datë 10.05.2017.</b></p> <p><i>Evidenca 4.1 Ngarkesa mesimore v.a 2018-2019</i>  <i>Evidenca 4.2 CV e stafit akademik dhe personelit ndihmes akademik</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Universiteti “Albanian University” ka nënshkruar kontrata të rregullta punësimi me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit Master shkencor në “Psikologji klinike”. Gjithashtu institucioni bën edhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të stafit. Kontratat e punës mbështeten në Kodin e punës, Ligjin e arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e AU. Ndër të tjera në kontratë parashikohet kohëzgjatja e kontratës, të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të pedagogut, zgjidhja e mosmarrëveshjes etj. Këto kontrata firmosen nga pedagogu përkatës, Dekani i Fakultetit dhe Rektori i AU.</p> <p><i>Evidenca 4.3 Model Kontrate PAE, PAK</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ndjek procedura rekrutimi korrekte të shpalljeve publike përmes mjeteve të komunikimit që insitucioni ka në dispozicion si faqja e universitetit dhe rrjetet sociale, sipas të gjitha kritereve. Vlerësimi bëhet mbështetur në thirrjen ku përfshihen kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ngrihet një komision ad-hoc i propozuar nga Departamenti i Psikologjise së përgjithshme i cili i përcillet Dekanit dhe miratohet nga Rektori, “Komisioni i vlerësimit të stafit akademik”, i përbërë nga Dekani, përgjegjësi i burimeve njëreze, zyra e zhvillimit të kurrikulës, përgjegjësi i departamentit si dhe një pedagog i brendshëm, të cilët bëjnë përzgjedhjen përfundimtare të personelit akademik. Zyra e Burimeve Njerëzore i kalon dosjet komisionit ad-hoc, i cili bën vlerësimin dhe përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit. Komisioni ad-hoc nëpërmjet Dekanit ia kalon Rektorit kandidatët e përzgjedhur për emërimin e kandidatit fitues.</p>

	<p><i>Evidenca 1.3 Rregullore e Pergjithshme Albanian University</i>  <i>Evidenca R.2 Procedure rekrutimi fillimi i vitit akademik 2021-2022; 2022-2023</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Master shkencor në “Psikologji klinike” nuk parashikon realizimin e orëve laboratorike.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e burimeve njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të përfshirë në këtë program studimi. Stafit akademik dhe mbështetës posedojnë dosje personale që përmbajnë të dhëna gjithëpërfshirëse. Kjo zyrë është përgjegjëse për menaxhimin e proceseve të rekrutimit si për personelin akademik me kohë të plotë ashtu edhe për atë me kohë të pjesshme, si dhe për personelin mbështetës akademik. Kjo zyrë mban evidencë për ngarkesën mësimore të stafit akademik për çdo semestër. Ky grup të dhënash përfshin anëtarët e stafit akademik pjesëmarrës në program, individin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, përfshirjen e secilit anëtar në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe kontributin e stafit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me përmbajtjen e dosjeve të stafit akademik me kohë të plotë, të cilat ishin të disponueshme për Zyrën e Burimeve Njerëzore. Dosjet kishin të gjithë dokumentacionin thelbësor për çdo pedagog.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën</p>	<p>AU ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme për realizimin e praktikës profesionale. Gjatë zhvillimit të orëve të praktikës studentët janë mbikëqyrur nga 1 ose dy pedagogë të kualifikuar me grada shkencor Doktor i shkencave dhe me përvojë në fushën aplikative.</p> <p>Për të respektuar rekomandimin e Bordit të Akreditimit, Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka shtuar numrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare apo subjekte të tjera. Marrëveshje të reja janë lidhur me institucione të ndryshme, si “Qendra për qasje të hapur</p>

<p>profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>në shkencë” në Beograd, “Universiteti jugperëndimor” në Bullgari, “Instituti për trajnim të avancuar psikologjik” në SHBA në bashkëpunim me “Rrjetin Ndërkombëtar i Praktikës së Psikoterapisë” në Angli, dhe “Tuf Medical Centre” në SHBA. Gjithashtu, është bërë një marrëveshje ndër të tjera me Universitetin Sigmund Freud në Vjenë. <i>Megjithatë, institucioni ka dështuar të sigurojë prova specifike në lidhje me zbatimin praktik të këtyre marrëveshjeve në kuadër të programit Master Shkencor në “Psikologji Klinike” (si praktika profesionale dhe kërkimi shkencor). Raportit të dorëzuar i mungon analiza thelbësore dhe është i kufizuar në raportimin bazë të emrave, duke mos përmbushur kërkesat e programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 1.3 Rregullore e Pergjithshme Albanian University</i> <i>Evidenca R.1 Lista e Marreveshjeve te Bashkepunimit</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në institucionet dhe organizatat ku studentët e programit Master shkencor në “Psikologji klinike” zhvillojnë praktikën profesionale, fillimisht dërgohet një kërkesë me shkrim nga ana e dekanatit për të pranuar studentin përkatës që të realizoj orët e praktikës profesionale. Pasi studenti pranohet nga institucioni, një nga anëtarët e stafit të institucionit i cili tipikisht ka rolin dhe detyrën e psikologut klinik merr përsipër të bëhet supervizori i studentit gjatë gjithë orëve që studentit ndjek praktikën. Për këtë studentit së bashku me supervizorin plotësojnë me shkrim skedën e studentit praktikant dhe e firmosin bashkërisht. Përveç supervizimit, monitorimit dhe mentorimit, supervizuesi bën edhe dy vlerësime për punën dhe angazhimin e studentit. Njëri vlerësim bëhet në përfundim të semestrit të parë dhe vlerësimi i dytë bëhet në përfundim të semestrit të dytë. Ky vlerësim zë 20% të vlerësimit total të studentit.</p> <p><i>Evidenca H.1 Rregullore e programit te studimit MSc. ne Psikologji Klinike</i> <i>Evidenca 2.3 Miratim udheheqesi praktika mesimore programet e studimit Master i Shkencave</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se Personeli akademik i angazhuar në këtë program përmbush kërkesat ligjore për nivelin e kualifikimit akademik dhe lëndët që ata mbulojnë janë në përputhje me formimin e tyre profesional. Megjithatë, për një pjesë të personelit akademik me kohë të pjesshme nuk janë aplikuar të njëjtat kritere dhe standarde të kualifikimit, duke rezultuar me nivel MSc të kualifikimit. Ngarkesa mësimore për personelin akademik efektiv</i></p>



	është në përputhje me kornizën ligjore, me një përmbajtje të qartë të orëve dhe lëndëve që mbulojnë. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme për realizimin e praktikës profesionale, por mungojnë prova specifike për zbatimin praktik të këtyre marrëveshjeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Universiteti “Albanian Univeristy” angazhohet në drejtim të përmirësimit të kushteve të përshtatshme për të realizuara detyrat e gjithsecilit sipas rolit dhe përgjegjësisë. Kapacitetet infrastrukturore në dispozicion, sallat e departamenteve, zyrat, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm. Bazuar në informacionet e marra nga takimet me stafin si dhe nga informacioni i siguruar nga RVB rezulton se mësimi fizikisht në auditor zhvillohet në përputhje me rregulloret e brendshme si dhe ligjet në fuqi. Këto sigurojnë krijimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave.  <i>Evidenca Tabela 16</i>
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore në Universitetin “Albanian University” janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimit në kushte bashkëkohore. Në RVB është shprehur nga GVB mbi rëndësinë që ka pajisja e këtij programi me një laborator të psikologjisë klinike. Edhe ky fakt qëndron.  <i>Evidenca 4.4 Planimetrive e godines</i>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e	Ky program studimi profesional zhvillohet në ambjentet e Universitetit “Albanian University”, në të cilin vihen në

<p>tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>dispozicion salla leksionesh dhe një laborator i informatikës. Bazuar në specifikat e Master shkencor në “Psikologji klinike” mjediset në dispozicion janë të favorshëm për të realizuar qëllimet mësimore të lidhura me përvetësimin e dijeve dhe kompetencave të kërkimore shkencore dhe profesionale të studentëve.</p> <p><i>Evidenca 4.4 Planimetrite e godines</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Mjediset mësimore në universitetin “Albanian University” janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të tilla si laptopë, PC, projektor, wireless, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Laboratori TIK, është i kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është i aksesueshëm për të gjithë studentët.</p> <p><i>Evidenca 4.4 Planimetrite e godines</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Institucioni disponon një listë marrëveshesh me institucione shtetërore, private dhe OJF për kryerjen e praktikave profesionale pranë tyre. Duke iu referuar marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të praktikës profesionale për Master shkencor në “Psikologji klinike” kemi disa marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e lartë Universitare “Nehemiah Gateëay” Pogradec; një tjetër institucion i quajtur SH.F.M.U. “Bajram Curri”, Romajë-Has; SH.F.M.U. “Xhevat Berisha”, Prizren; “Qendra për Shërbime Psikologjike të Integruara” Tiranës, një institucion ndërkombëtar “International Network of Democratic Therapeutic Communities”, Bashkia Tiranë, organizata “Rrjeti Akademik Shqiptar” dhe Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multi-funksionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”, “Qendra për qasje të hapur në shkencë” në Beograd, “Universiteti jugperëndimor” në Bullgari, “Instituti për trajnim të avancuar psikologjik” në SHBA në bashkëpunim me “Rrjetin Ndërkombëtar”. i Praktikës së Psikoterapisë” në Angli, dhe “Tuf Medical Centre” në SHBA. Marrëveshjet e nënshkuara nga AU në funksion të realizimit të praktikës profesionale kanë impakt në cilësinë e programit të</p>

	studimit Master shkencor në "Psikologji klinike". <i>Evidenca R.1.a Lista e Marreveshjeve te Bashkepunimit Tabela 5</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon Universiteti "Albanian University" siguron mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit Master në "Psikologji Klinike". Mjediset janë të pajisura me teknologji bashkëkohore dhe infrastruktura të nevojshme, si poste pune, kompjuterë, sisteme kondicionimi dhe ndriçimi. Është e nevojshëm ngritja e një laboratorit të psikologjisë klinike për të hulumtuar më tej si nga ana e stafit akademik po ashtu dhe studentët. Procesi mësimor zhvillohet në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi, duke krijuar kushte të barabarta për të gjithë. Institucioni ofron ambiente moderne, përfshirë sallat e leksioneve dhe laboratorin e informatikës, të pajisura me pajisje teknologjike si laptopë, PC, projektorë dhe akses në internet. GVJ sugjeron që Institucioni të rregullojë praktikat profesionale përmes marrëveshjeve specifike në terma specifike.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë për çdo lëndë dhe modul të programit të studimit e vënë në dispozicion të studentëve është në gjuhën shqipe. Ndërkohë një pjesë e lëndëve si literaturë ndihmëse kanë rekomanduar edhe literatura të huaja kryesisht në gjuhën angleze. Literaturat janë në përputhje të plotë me objektivat e lëndëve dhe garantojnë marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme për studentët e psikologjisë. Pjesa më e madhe e lëndëve është mbuluar me tekste universitare të cilat janë botuar kryesisht para një dekade. Disa lëndë kanë përdorur libra universitarë të autorëve të huaj të përkthyer në shqip, dhe shumë lëndë të tjera kanë përdorur literaturë të autorëve shqiptarë. <i>Evidenca 2.1 Kurrikula e programit te studimit MSc. ne Psikologji Klinike Evidenca 4.5 Lista e titujve te librave ne biblioteke</i>

	<i>Evidenca Silabuset</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Në vizitë në AU pedagogët dëshmuar që njësia përgjegjëse raporton nevojat për përditësime të literaturës me botime të 5 viteve të fundit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e Universitetit “Albanian University” ka hapësira dhe u jep mundësi studentëve të bëjnë kërkime online apo të studiojnë materiale fizike në një mjedis me hapësira dhe kushte komode për studim. Ajo është e pajisur me tavolinë studimi, dy kompjutera dhe internet pa limit përmes sistemit ëi-fi për të gjithë studentët dhe anëtarët e personelit që duan të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës për shfletim të literaturës për nevoja të ndryshme. AU disponon një Bibliotekë e cila ka një fond librash, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, duke përfshirë edhe tituj të fushave të ndryshme, ndër të cilat ka dhe tituj të fushës së psikologjisë, sociologjisë dhe filozofisë. Krahas literaturës fizike, institucioni përdor materiale ndihmëse dhe informuese për studentët si dhe forma e leksioneve në Pdf të cilat i vihen në dispozicion studenteve nëpërmjet faqes online. Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë dhe të aksesojë bibliotekën online.  <i>Evidenca 4.4 Planimetrite e godines</i> <i>Evidenca 4.5 Lista e titujve te librave ne biblioteke</i>
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Kapaciteti që ka biblioteka nuk garanton deri diku mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Për fushën e psikologjisë janë më shumë libra në versionin online sesa në atë të printuar. AU bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit, duke përfituar edhe nga donacionet e pedagogëve me botimet e tyre.  <i>Evidenca 4.5 Lista e titujve te librave ne biblioteke</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në	Stafi akademik dhe studentët e programit të studimit Master shkencor në “Psikologji klinike” kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformat elektronike të aksesimit në tre bibliotekat online. AU ka vënë në dispozicion bibliotekën online në Elsevier, Eric, Cambrige Journals. Pranë

<p>bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>bibliotekës të AU kishte një numër të konsiderueshëm tekstesh online në fushën e psikologjisë, të cilat mund të përdoren nga stafi dhe studentët. AU bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit, duke përfutuar edhe nga donacionet e pedagogëve me botimet e tyre.</p> <p><i>Evidenca 4.5 Lista e titujve te librave ne biblioteke</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Shërbimet e bibliotekës ofrohen pa pagesë për të gjithë studentët e AU dhe për personelin e institucionit. Për t'u bërë anëtar i bibliotekës mjafton një regjistrin i thjeshtë me një kartë indentiteti dhe studenti hap librezën e bibliotekës. Përmes saj, studentët dhe stafi kanë të drejtë të tërheqin libra nga biblioteka për afate të përcaktuara. Biblioteka on-line Elsevier, Eric, Cambridge Journals ofrojnë gjithashtu akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët si fizikisht ashtu dhe në biblioteka on-line.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka punon gjatë orarit 08.00-16.00 Hënë-Premte, dhe ditën e Shtunë 08.00-12.00. Studentët njihen me orarin në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Gjatë vizitës në bibliotekë, konstatoam që edhe gjatë sezonit të provimeve biblioteka ka të njëjtat orare. Çdo student konstatoam që kishte kartelë rregjistrimi.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online,</p>	<p>Në fushën e psikologjisë biblioteka e universitetit disponon rreth 560 kopje fizike me vite botimi që variojnë nga viti 1948-2019. Nga këta 63% janë libra në gjuhën shqipe dhe 37% janë në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht dhe gjermanisht.</p>

cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.									
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Konstatohet se programi i studimit përfshin literaturë të përditësuar dhe të nevojshme, në përputhje me objektivat e lëndëve. Biblioteka e universitetit ofron hapësira të përshtatshme për studim dhe është e pajisur me literaturë të mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj. Aksesimi në bibliotekat online dhe fondi i librave elektronikë për psikologjinë janë avantazhe shtesë që mbështesin procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Megjithatë, literatura bazë e disa lëndëve është e botuar para një dekade, duke sugjeruar nevojën për përditësime të vazhdueshme me botime më të reja për të siguruar një bazë të njohurive të freskëta për studentët.</i></p> <p><i>Sugjerim: Rekomandohet që universiteti të përshpejtojë procesin e përditësimit të literaturës bazë me botime të pesë viteve të fundit dhe të zgjerojë koleksionin e librave fizikë dhe elektronikë në bibliotekë, duke përfshirë më shumë burime aktuale dhe të përparuara në fushën e psikologjisë klinike.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>I gjithë informacioni në lidhje me studentët e AU menaxhohet nga sekretaria mësimore e programit të studimit përkatës, kryesekretarja e fakultetit si dhe administratori i përgjithshëm. Të dhëna në lidhje me studentët që nga pranimi deri në diplomim, statistika vjetore të ndryshme në lidhje me studentët, apo dhe largimet para përfundimit të programit të studimit etj, janë të ruajtuara jo vetëm në variant hardcopy por dhe elektronikisht. Në variantin elektronik janë të ruajtuara edhe të dhënat të rregjistruara në Rregjistrin Themeltar, Rregjistrin e Indeksit, Rregjistrin e Rezultateve Akademike, Rregjistrimin e Diplomave.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua nga AU që institucioni ka implementuar platformën “Pitagora” nga Rrjeti Akdemik Shqiptarë për menaxhimin e brendëshëm të informacionit.</p>

	<i>Evidenca 4.6 Rregullore e sekretarise mesimore</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	AU nuk ka një platformë e cila ti shërbejë drejtpërsëdrejti sistemit të brendshëm të menaxhimit që administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Megjithatë i gjithë dokumentacioni në formë elektronike, si dhe komunikimet e stafit me kolegë dhe studentë realizohen përmes Microsoft office Outlook, Teams.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Ashtu sic u shprehem edhe me lart, AU nu ka nje sistem/platformë te menaxhimit te brendshëm te informacionit dhe forma e komunikimit dhe ndarjes se informacionit është Emaili zyrtar, të cilin e përdorin stafi akademik, ndihmës akademik, stafi akademik me kohë të pjesshme dhe studentët.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Komunikimi midis stafit akademik dhe studentëve në AU mundësohet përmes platformës Microsoft Teams që AU ka vënë në dispozicion të stafit dhe studentëve. Kjo platformë shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Po ashtu institucioni ruan dhe komunikimin dhe koordinimin midis stafit akademik dhe studentëve si fizikisht ashtu dhe me anë të kontakteve telefonike dhe e-maileve zyrtare të tyre.  <i>Evidenca H.1 Rregullore e programit te studimit MSc. ne Psikologji Klinike</i> <i>Evidenca 2.1.b Rregullore e Departamentit te Psikologjise se Pergjithshme</i>
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	AU zotëron faqen zyrtare <a href="http://www.albanianuniversity.edu.al">www.albanianuniversity.edu.al</a> . Në këtë faqe publikohen të gjithë aktivitetet akademike dhe administrative të cilat zhvillohen në universitet. Aktivitetet pasqyrohen në gjuhën shqipe dhe anglisht. Gjithashtu, aktivitetet që ndodhin në AU pasqyrohen dhe në rrjetet sociale të cilat janë në pronësi të institucionit.
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin	Në faqen zyrtare të “Albanian University” janë të publikuara të gjitha të dhënat mbi Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme si dhe programet që ky department ofron. Në ëbsite të AU janë të

akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	pasqyruara të dhëna dhe për stafin akademik të departamentit. Të dhënat pasqyrohen në gjuhën shqipe dhe anglisht.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se Universiteti "Albanian University" disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit për administrimin dhe monitorimin e aktiviteteve akademike, financiare dhe administrative. Informacioni i studentëve menaxhohet nga sekretaria mësimore dhe ruhet si në format hardcopy, ashtu edhe elektronikisht. Institucioni ka implementuar platformën "Pitagora" për menaxhimin e brendshëm të informacionit, ndërsa komunikimi dhe koordinimi i stafit akademik dhe studentëve realizohet përmes Microsoft Office Outlook dhe Teams. Faqja zyrtare e universitetit dhe rrjetet sociale të tij pasqyrojnë aktivitetet akademike dhe administrative, duke ofruar transparencë dhe informim të vazhdueshëm për të gjithë palët e interesuara.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga intervistat e zhvilluara me Dekanin e Fakultetit GVJ konstatoi se Buxheti vjetor i akordohet AU nga Shoqëria UFO sh.p.k në përputhje me nevojat që ka si institucion. Ky buxhet bazohet në programin afatmesëm tre vjeçar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Buxheti vjetor i AU dhe buxheti afatmesëm tre vjeçar, diskutohen në Rektorat, më pas në Senatin Akademik. Senati Akademik pasi e miraton paraprakisht ia kalon për miratim final Bordit të Administrimit të AU. GVJ konstatoi që plani i financimit të progamit hartohet duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren. AU harton pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin e institucionit.



<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Nga intervistat e zhvilluara me Dekanin e Fakultetit GVJ konstatoi se plani i financimit të programit të studimit përfshin në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekat on-line. Ky plan financimi i programit të studimit Master shkencor në “Psikologji klinike” është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni kryen auditim të përvitshëm bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni kryen auditim të brendshëm me anë të Zyrës së Auditit të brendshëm si dhe auditim të jashtëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare. Zyra e Auditit të brendshëm është njësi administrative e ngritur dhe funksionale brenda institucionit e cila ka si mision kontrollin e procedurave dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të zyrës së financës dhe auditit të brendshëm.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Duke iu referuar RVB së, konstatojmë se AU ka të dokumentuara raportet financiare të tre viteve të fundit, procedurat e të cilave fillojnë të kryhen gjatë periudhës Mars-Maj. Rektorati përgatit raportin financiar të realizuar, mbështetur në planifikimet e kryera në programin financiar. Ky raport miratohet nga Bordi i Administrimit. Në përfundim të kësaj faze realizohet edhe një analizë që planifikon ndërhyrjet e nevojshme në të ardhmen për mbarëvajtjen e programve të studimit.</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Duke iu referuar dhe numrit të studentëve të rregjistruar çdo vit në këtë program studimi, konstatojmë si GVJ se ky program ka qëndrueshmëri financiare të mjaftueshme për përmirësim të ndjeshëm dhe gjenerim të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> <p><i>Evidenca Tabela 23</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti "Albanian University" garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për procesin mësimor-kërkimor dhe mbështetjen e studentëve, me buxhetin e akorduar nga Shoqëria UFO sh.p.k. Ky buxhet, i hartuar sipas një programi afatmesëm tre vjeçar, miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Institucioni kryen auditime të brendshme dhe të jashtme për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe përgatit raporte të rregullta financiare. Plani i financimit përfshin të gjitha shpenzimet operationale dhe mbështetëse, duke garantuar stabilitet financiar dhe mundësi për përmirësim të vazhdueshëm.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--


## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p><b>Standardi V.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Si GVJ konstatoam se informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu, informacion mbi organigramën e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, dhe strukturën e programit të studimit afishohet në stendat e AU si edhe një informacion më pak i detajuar shfaqet në faqen e internetit të AU. Ky program studimi është organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret dhe kuotat e pranimit, procedurën e aplikimit publikohet online dhe është pjesë e fushatave informuese përmes broshurave.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me të drejta të plota për të gjithë. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve.</p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>AU në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimin e Senatit si dhe Rregulloret e këtij programi studimi, ka miratuar kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, dhe i pasqyron këto informacione edhe në faqen zyrtare duke i mundësuar aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë. Pranimi i studentëve në programin Master shkencor në “Psikologji klinike” është rregulluar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit vendoset nota mesatare në hyrje për çdo vit akademik.</p>




	<p><i>Në vizitën në AU nuk u paraqit asnjë evidencë e tillë që AU të ketë një vendimarrje në lidhje me vendosjen e mesatares si kriter hyrës në këtë cikël studimi.</i></p> <p><i>Evidenca 1.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore</i>  <i>Evidenca 5.1 Vendim i Bordit të Administrimit për kuotat e pranimit</i>  <i>Evidenca 5.2 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit</i>  <i>Evidenca 5.3 Panairi Eork&amp;Study</i>  <i>Evidenca 5.4 Udhezues orientues për maturantët</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në faqen zyrtare të Universitetit “Albanian University” janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studentit. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në faqen e AU mbi këtë procedurë dhe dokumentat e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi.</p> <p><i>Evidenca H.1 Rregullore e programit të studimit MSc. në Psikologji Klinike</i>  <i>Evidenca 2.5 Rregullore e Zyres së Regjistrimeve dhe Transferimeve</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Albanian University” angazhohet përmes një sërë formash në promovimin dhe reklamimin e programeve të studimit kryesisht duke përdorur faqen zyrtare të webi dhe faqen zyrtare në facebook. Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në AU.</p> <p><i>Evidenca 5.3 Panairi Eork&amp;Study</i>  <i>Evidenca 5.4 Udhezues orientues për maturantët</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të</p>	<p>Format, me të cilat realizohen udhëzimi i studentëve, në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t’u regjistruar në programin e Master shkencor në “Psikologji klinike”, janë të shumta si këshillimi në ambjentet AU gjatë periudhës së regjistrimeve, etj.</p>



veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, Albanian University vendos dhe konfirmon kriteret dhe kuotat. Këto kritere dhe kuota përfshijnë kategori të ndryshme kandidatësh, si ata me aftësi të kufizuara, minoritete, kandidatë nga shtresat e margjinalizuara. IAL shprehet se ,për vitin akademik 2022-2023, Senati Akademik, në vendimin e tij nr. 4, më datë 09.03.2023, miratoi gjithsej 7 kuota për studentët me status jetim, 3 kuota për personat me aftësi të kufizuara, 1 kuotë për komunitetin rom dhe ballkano-egjiptian dhe 69 kuota për studentët nga trojet. Përzgjedhja e kandidatëve fitues bazohet në kriteret e përgjithshme të miratuara nga AU.</p> <p><i>Evidenca 5.4 Udhezues orientues per maturanet</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Përpara çdo viti akademik, institucioni formulon dhe nxjerr kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e huaja. AU formulon dhe nxjerr kritere dhe udhëzime për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e huaja. Përpara fillimit të çdo viti akademik, Albanian University përcakton kërkesat e pranimit për të gjitha llojet e aplikantëve. Senati Akademik ka miratuar këto kritere, të cilat më pas dërgohen në MAS dhe vihen në dispozicion në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p><i>Evidenca 5.4 Udhezues orientues per maturanet</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>AU zhvillon politika për të ndihmuar studentët që u përkasin klasave sociale në disavantazh dhe kategorive të veçanta. AU i propozon Senatit Akademik dhe miraton tek Bordi i Administrimit, kategorizimin e studentëve që përfitojnë bursa të ndryshme studimi. Përveç programit të ekselencës, i cili bazohet në arritjet e studentëve, përfshihen edhe kategori si fëmijët e policëve të rënë, fëmijët e rritur në institucione, individët me aftësi të kufizuara, studentët e komunitetit rom etj.</p> <p><i>Evidenca 5.4 Udhezues orientues per maturanet</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Sugjerimet e GVJ për njësinë bazë që të shoh mundësinë e vendosjes së kriterëve të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për të vijuar studimet në Master shkencor në "Psikologji klinike" me vijimësi në ciklin e parë të studimeve në Psikologji me qëllim që të lehtësohet jo vetëm trasmetimi i dijeve dhe njohurive në auditor për një grup homogjen studentësh.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Universiteti “Albanian University” vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore, por edhe takimet informuese që realizohen ditët e para të fillimit të vitit akademik, lehtësojnë njohjen e studentit me këto procedura.</p> <p><i>Evidenca H.1 Rregullore e programit të studimit MSc. në Psikologji Klinike</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	<p>Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet “Java e Orientimit”, e cila është e përvitshme në AU. Gjatë kësaj jave realizohen takime, leksione të hapura për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të AU. Në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit. AU mundëson transferimin e studentëve sipas akteve ligjore në fuqi, procedurave të parashikuara në rregulloren mësimore si dhe në rregulloren e rregjistrimeve dhe transferimeve. Njësia bazë disponon një procedurë për njohjen e studimeve të mëparshme. Në fillim të çdo viti akademik Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme bën të mundur ngritjen e Komisionit të Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve i cili është i përbërë nga stafi akademik me një përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe njohës të specializuar të arsimit të lartë. AU ka procedura të unifikuara për të gjithë njësitë e tij, të cilat janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të silabusit të lëndës. Njësia bazë përmes strukturave të saj informon studentët e programit profesional përgjatë fundit të semestrit të parë dhe fillimit të semestrit të dytë në lidhje me Provimin e diplomës. Për provimin e përgjithshëm përfundimtar jepet një udhëzim në lidhje me tematikat e përfshira. Fazat kohore të mbrojtjes së diplomës përmes provimit me shkrim bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e</p>


	<p>këtyre procedurave që lidhen me provimin e përgjithshëm përfundimtar e realizon koordinatori dhe drejtuesi i njësisë bazë.</p> <p><i>Evidenca 2.5 Rregullore e Zyres se Regjistrimeve dhe Transferimeve</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>AU ka procedura të unifikuara për të gjithë njësitë e tij, të cilat janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të silabusit të lëndës. Zyra e koordinimit dhe mbështetjes për studentët dhe Këshilli studentor janë në dispozicion të studentëve gjatë javës së parë të vitit akademik, në bashkëpunim të ngushtë me stafin akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme.</p> <p><i>Evidenca H.1 Rregullore e programit te studimit MSc. ne Psikologji Klinike</i> <i>Evidenca 2.1.b Rregullore e Departamentit te Psikologjise se Pergjithshme</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se në rregulloren e diplomimit, studentët njihen me udhëzime të specifikuara lidhur me strukturën e punimit të diplomës, i cili është gjithashtu është pjesë e prezantimit që bëhet në fillim të vitit akademik. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e këtyre procedurave që lidhen me mbrojtjen e diplomës me temë e realizon koordinatori i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme në bashkëpunim me njësinë bazë dhe stafin akademik.</p> <p><i>Evidenca 3.9.a Kerkese per zhvillimin e temes se diplomes</i> <i>Evidenca 3.9.b Manual i punimit te temes se diplomes</i> <i>Evidenca H.1 Rregullore e programit te studimit MSc. ne Psikologji Klinike</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi. Në lidhje me tërheqjen e studentëve të rinj çdo fillim vitit akademik AU përmes Zyrës së koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve në bashkëpunim me Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë të cilët informojnë studentët me programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t'i ndihmuar ata në vendimarrje. Format si njoftimet në faqen zyrtare të ëeb, rrjetet sociale, stendat e AU dhe manualit të studentit ndërmerren me qëllim tërheqjen e studentëve të interesuar.</p>

	<i>Evidenca 5.5 Manifesti Akademik</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se Universiteti "Albanian University" ofron informacion të plotë dhe të hollësishëm për përparimin akademik të studentëve, duke përfshirë procedurat për transferim, njohje të kredive, dhe kriteret për kalimin nga një vit në tjetrin. "Java e Orientimit" është një event i rëndësishëm që ndihmon studentët e rinj të njihen me programin dhe rregulloret. Procedurat për diplomim dhe mbrojtjen e diplomës janë të qarta dhe monitorohen rregullisht nga stafi akademik dhe departamenti. Për të tërhequr studentë të rinj, AU promovon aktivitetet dhe shërbimet e tij në mënyra të ndryshme, duke përfshirë rrjetet sociale dhe materialet informative.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve përmes një mori formash. Studenti informohet duke nisur me informacionin në faqen online të AU, përmes kontratës që nënshkruan, informacionit që merr nga Zyra e koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve, këshillimit nga stafi akademik në faza të ndryshme si dhe rregullores mësimore të programit të studimit.  <i>Evidenca H.1 Rregullore e programit të studimit MSc. në Psikologji Klinike</i> <i>Evidenca 2.1.b Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Duke iu referuar RVB si dhe takimeve gjatë vizitë në institucion konstatuam se AU vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion mbi kurrikulën dhe programin e studimit, i cili mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit, gjatë ditëve të orientimit. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në bashkëpunim me Zyrën e koordinimit dhe mbështetjes për studentët, Zyrën e



	Karrierës dhe Alumnit, organizon takime informuese me studentët si dhe u prezanton studentëve Broshura. Syllabuset e lëndëve mësimore përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni ka në dispozicion të orientimit profesional të studentëve Zyrën e koordinimit dhe mbështetjes për studentët dhe Zyrën e Karrierës dhe Alumnit, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre duke bashkëpunuar ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti. Gjatë takimeve në AU, GVJ u informua në lidhje me organizimin e panairëve të punës dhe aktiviteteve të tilla si leksione të hapura me aktorë nga tregu i punës si pjesë e realizimit të praktikës profesionale, si veprimtari që synojnë të qartësojnë studentët dhe të orientojnë rreth mundësive për punësimin e tyre.  <i>Evidenca 5.6 Leksion i hapur - Si te punosh - Silvana Vishkurti - 17.03.2022</i> <i>Evidence 5.7 Leksion i hapur - Si te menaxhoni stresin</i>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Cdo informacion vihet në dispozicion të studentëve, sidomos gjatë javës orientuese. Informacioni në lidhje me infrastrukturën dhe programin e studimit vihet në dispozicion në faqen zyrtare të "Albanian University", si dhe në të gjitha rrjetet sociale ku ky univeristet ka llogaritë e veta zyrtare, në syllabuset e lëndëve përkatëse etj.  <i>Evidenca 5.8 Axhenda e javës orientuese</i>
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ ka konstatuar se AU nuk ka një sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit, por arrin të përmbush informimin përmes mënyrave të tjera elektronike. Siç u lartpërmend, AU i ka të shpallura informacionet në lidhje me programin e studimit Master shkencor në "Psikologji klinike", në ëëbin zyrtar <a href="http://ëëë.albanianuniversity.edu.al">ëëë.albanianuniversity.edu.al</a> si dhe në postimet e ndryshme në rrjetet sociale përmes llogarive zyrtare që disponon AU.
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se Universiteti "Albanian University" ofron informacion të plotë dhe të hollësishëm për programin e studimit Master shkencor në "Psikologji Klinike", duke përfshirë objektivat formuese, strukturën e programit, si dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit. Ky informacion jepet përmes</i>



	<p><i>faqes zyrtare të institucionit, kontratës së regjistrimit, takimeve orientuese dhe broshurave të ndryshme. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dhe Zyrat e Koordinimit dhe Mbeshtetjes për Studentët dhe Karrierës dhe Alumnit janë në dispozicion për të ofruar këshillim dhe informacion shtesë. Aktivitete si panairë të punës dhe leksione të hapura me ekspertë nga tregu i punës ofrojnë perspektivë të qartë për mundësitë e karrierës për studentët. Informacioni është i lehtësisë për gjetje në faqen zyrtare të AU dhe në rrjetet sociale të institucionit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>I gjithë informacioni i studentëve ndër vite menaxhohet nga sekretaria mësimore, kryesekretarja e fakultetit si dhe nga Administratori i përgjithshëm. Të gjithë të dhënat e studentëve gjenden të rregjistruara në databasën e sekretarisë mësimore si dhe në regjistrin themeltar të notave. Gjatë vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me dosjet e studentëve dhe regjistrin themeltar të tyre. Sekretaria disponon statistika për të diplomuarit në vite në hardcopy dhe elektronikisht. Numri i studentëve të rregjistruar është</p> <p>Viti akademik 2019-2020 25 Studente  Viti akademik 2020-2021 25 Studente  Viti akademik 2021-2022 11 Studente  Viti akademik 2022-2023 19 Studente</p> <p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion numri i studentëve të diplomuar për tre vite akademike në këtë program rezultoi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2019-2020 - 16 studentë;</li> <li>- Për vitin akademik 2020-2021 - 19 studentë;</li> <li>- Për vitin akademik 2021-2022 - 18 studentë;</li> </ul> <p><i>Evidenca Tabela 23</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për</p>	<p>Çdo student është i pajisur me dosjen personale, pavarësisht statusit që ka si student efektiv, i çrregjistruar nga programi i</p>

<p>numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>studimit, apo si ish student. I gjithë ky dokumentacion gjendet i arkivuar pranë sekretarisë mësimore, kryesekretarisë së Fakultetit. Çdo vit AU harton statistikën vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, të largimeve para përfundimit të programit apo të mospërfundimit me sukses të programit të studimit si dhe të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p> <p><i>Evidenca Tabela 23</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Zyra që merret me regjistrimin e studentëve, sekretaria mësimore në AU është strukturë e posaçme që merret me ruajtje dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e saj në drejtim të menaxhimit të rekordeve të studentëve realizojnë edhe përmes sistemit informatik të regjistrave dhe arkivave të të dhënave të plota. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e AU. Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit dhe vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin informatik për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Statuti Albanian University</i> <i>Evidenca 4.6 Rregullore e sekretarisë mesimore</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Informacioni për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre janë online dhe në regjistrat e sekretarisë mësimore dhe të disponueshme për studentët, departamentin apo dhe universitetin gjatë gjithë periudhës së studimit. Sistemi i menaxhimit të informacionit aktual ofron funksionalitetin e nevojshëm për stafin akademik, administratën dhe ecurinë e studentëve për gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga regjistrimi në programin e studimit, vlerësimet e deri në diplomimin e tyre. Paketa softëare Pitagora (2023) mundëson një database të dhënash mbi studentët për cikël studimi.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Statuti Albanian University</i> <i>Evidenca 4.6 Rregullore e sekretarisë mesimore</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe</p>	<p>Raportet analitike mbi profilet e studentëve të ardhur, aktualë si dhe shkalla e punësimit të studentëve në AU realizohen nga Zyra e sekretarisë mësimore, zyrës së Karrierës dhe Alumnit si dhe</p>

<p>cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamentit të Psikologjisë së përgjithshme. Nga të dhënat që paraqet zyra e Karrierës dhe Alumnit rezulton se pothuajse gjysma e të diplomuarve në programin Master shkencor në “Psikologji klinike” janë të punësuar në profilin e psikologut klinik në institucion publike dhe jo publike.</p> <p><i>Evidenca Tabela 23</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstatoi gjatë vizitës në AU se të dhënat statistikore burojnë nga Rregjistri themeltar, Rregjistri i Indeksit, Rregjistri i rezultateve akademike si dhe Rregjistri i diplomave. Të dhënat statistikore gjenden në AU në version elektronik dhe letër. Këto të dhëna raportohen rregullisht pranë MASR dhe rektoratit të AU.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>AU parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse. Përfshirja e studentëve në një sërë strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli studentor, Komisioni për kurrikulat dhe mësimin, Komisioni për vlerësimin intitucional, Komisionin për kërkimin shkencor dhe Botimin, si dhe në komisionet për hartimin e RVB në raste akreditimi institucional ose programesh studimi është përcaktuar në aktet ligjore dhe rregulloren dhe statutin e vetë AU.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Statuti Albanian University</i>  <i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>  <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo</p>	<p>Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve në AU. Ato janë pjesë aktive e mbedhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari.</p>


<p>vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në grupime studentore në lidhje me fushën e studimit dhe sipas interesave personale. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes pyetësorëve dhe përmes takimeve në grup.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Statuti Albanian University</i>  <i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>  <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Studentët përfshihen në Komisionin për kurrikulat dhe mësimin, Komisioni për vlerësimin Institucional si dhe Komisioni për kërkimin shkencor dhe botimin (Komisione të përhershme). Duke pasur këtë përfshirje në vendimmarrje idetë dhe sugjerimet e tyre merren në konsideratë për të rishikuar dhe përmirësuar programin e studimit.</p> <p>GVJ konstatoi edhe gjatë vizitës në institucion përfshirjen e studentëve në procese të rëndësishme të zhvillimit të programit të studimit Master shkencor në “Psikologji klinike”. Gjatë intervistës me GVB studentja u përfshi në diskutimet në lidhje me ecurinë e programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 1.2 Statuti Albanian University</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të programit të studimit. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.</p> <p><i>Evidenca H.1 Rregullore e programit te studimit MSc. ne Psikologji Klinike</i>  <i>Evidenca 3.6 Format kerkese per rishikimin e tezes</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstatoi institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse dhe këshilluese për hartimin, miratimin, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit. Përfshirja e studentëve në strukturat vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli Studentor dhe komisionet e ndryshme është e rregulluar në aktet ligjore dhe rregullore të AU. Studentët angazhohen</p>




	<i>aktivisht në diskutimet dhe vendimet në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, kurrikulën dhe proceset e vlerësimit. Përmes komisioneve dhe grupimeve studentore, idetë dhe sugjerimet e tyre merren në konsideratë për të përmirësuar programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ka Zyrën e Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, e cila është në shërbim të informimit të studentëve. Kjo zyrë përdor faqen zyrtare të ëëbit <a href="http://ee.albanianuniversity.edu.al">ëëbit ëëë.albanianuniversity.edu.al</a> ku pasqyron aktivitetet që zhvillohen në AU dhe përditëson informacione të detajuara për studentët, stafin dhe palët e treta. Institucioni është aktiv dhe në rrjetet sociale.  <i>Evidenca 5.9 Rregullore Zyra e koordinimit dhe mbështetjes per studentet.</i> <i>Evidenca 5.10 Rregullore Zyra e karrieres dhe Alumnit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	AU ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar si dhe vizitës në institucion vihet re se veprimtaria e kordinatorit të programit, njësia bazë dhe Zyra e Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve orientohen drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e rregjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj. Zyra e Karrieres dhe Alumnit ka hartuar Udhëzuesin e studentëve për zhvillimin e karrierës i cili i vihet në dispozicion studentëve. Po ashtu ky institucion me qëllim mbështetjen profesionalisht të studentëve dhe ti ndihmojë ata në planifikimin e karrierës ofron dhe udhëheqje dhe kujdestari (tutorat) për studentët dhe përgjegjëse për këtë është zyra koordinimit dhe e mbështetjes

	<p>ndaj studentëve e cila ofron mbështetje në drejtim të koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve për tu orientuar në tregun e punës.</p> <p><i>Evidenca 5.11 Manuali i studentit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e kordinimit dhe mbështetjes ndaj Studentëve si dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Këto zyra janë në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Në AU funksionon Alumni, me të cilët bëhen takime të përvitshme për të marrë mendime, ndarë eksperiencë në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t’iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. Këshilluesi i karrierës është në dispozicion të studentëve gjatë gjithë javës dhe ofron një sërë shërbimesh si këshillim karriere, informacion mbi vende të lira pune, informacion mbi praktikën profesionale, informacion në lidhje me trajnimet dhe ëorkshop-et etj.</p> <p><i>Evidenca 5.12 Udhezuesi i karrieres</i>  <i>Evidenca 5.13 Aktivitete ekstrakurrikulare</i>  <i>Evidenca Tabela 5</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve është një strukturë e ngritur e cila funksionon në bazë të statutit të AU e cila ka si objektiv të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit. Shpesh luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentit drejt mundësive të punësimit, por edhe në drejtim të ofrimit të këshillimit për karrierën me qëllim vlerësimin më objektiv të mundësive që studenti ka në dispozicion.</p> <p><i>Evidenca 5.14 Statistika te punesimit te studenteve</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se Institucioni ofron një infrastrukturë të pasur për pritjen, orientimin, këshillimin dhe menaxhimin e ankimimeve të</i></p>



	<p><i>studentëve. Përmes Zyrës së Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit, studentët mbështeten me informacion dhe këshillim për trajtimin e çështjeve të tyre akademike dhe profesionale. Ky shërbim përfshin edhe udhëzim për zgjedhjen e karrierës dhe përgatitjen për tregun e punës. Alumni dhe këshilluesi i karrierës ofrojnë një platformë për ndarjen e përvojave dhe këshillimin për zhvillimin e karrierës së studentëve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit kemi disa element të dallueshëm. Universiteti “Albanian University” ka miratur një grup pune, i cili do të drejtojë këtë strukturë, ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme. Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>Evidenca 1.3 Rregullore e Pergjithshme Albanian University</i>  <i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>  <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit	Struktura e NJSBC në AU është një strukturë e ngritur që në vitin akademik 2009-2010. Kjo njësi është ngritur konform ligjit të arsimit të lartë, Kodit të cilësisë, si dhe me Vendim të Senatit



<p>dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>akademik të AU me nr 178, datë 23/07/2010. Gjithashtu, në mënyrë që sistemi i sigurimit të cilësisë të konsolidohet më tej AU ka ngritur me vendim të Senatit akademik edhe Komisionin e Përhershëm të vlerësimit institucional, strukturë në të cilën AU ka përfshirë dhe një student. Studentët janë të përfshirë gjithashtu, edhe në rastet kur AU ndërmer akreditime të jashtme në nivel institucional ose të programeve të studimit. AU me qëllimin e konsolidimit të kulturës së cilësisë në institucion ka ngritur gjithashtu dhe Grupin e Sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë, ku anëtarësia e grupit përditësohet çdo vit. AU ka të miratuar në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë edhe Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. AU në zbatim të Strategjisë institucionale si dhe Strategjisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë me qëllimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë të programeve dhe kurrikulave angazhon ekspertë të jashtëm.</p> <p><i>Evidenca 1.3 Rregullore e Pergjithshme Albanian University</i>  <i>Evidenca 3.3 Shembull pyetësori i plotësuar ne Forms</i>  <i>Evidenca 3.7 a/b Shembull raporti semestral PAE/PAK</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Departamenti angazhohet në proceset për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultet. Në departament janë të krijuara grupet e punës për hartimin e RVB-ve të programeve të studimit dhe në përbërje të këtyre grupeve janë të përfshirë pedagogë dhe studentë. AU bën përpjekje për të vlerësuar përvojat e fituara. Në FSHSH është ngritur dhe funksionon Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) për programet e studimit e cila bën vlerësimin për aspekte të ndryshme lidhur me realizimin e programit të studimit. Ky vlerësim bazohet në shpërndarjen në adresat elektronike të studentëve përkatës të pyetësorit të miratuar paraprakisht në Dekanat përpara sezonit të provimeve. Rezultatet e pyetësorëve diskutohen në departament dhe përcillen në Dekanat, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të punës në të gjitha aspektet, sidomos në problematikat e evidentuara nga studentët.</p> <p><i>Evidenca 6.1 Vendim Senati Akademik - krijimi i Zyres se Sigurimit te Brenshem dhe Cilesise 23.07.2010</i>  <i>Evidenca 6.2 Vendim Senati Akademik - Krijimi i Komisionit per Vleresimin Institucional 22.12.2016.</i>  <i>Evidenca 6.3 Vendim Senati Akademik - Pedagoget pergjegjes per Sigurimin e Cilesise ne nivel departamenti</i></p>

	<i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Institucioni ka aplikuar për riakreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat burokratike që lidhen me këtë proces. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të riakreditimit për këtë program studimi, por jo vetëm. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.
	<i>Evidenca 3.3 Shembull pyetesori i plotësuar ne Forms</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes planit të saj të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë trajnime me stafin akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e këtyre trajnimeve janë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencorë, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët e departamenteve dhe senati akademik. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në universitet, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme plotëson raportin e vetvlerësimit të programit. Në këtë raport paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësime në të ardhmen, feedbacku i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve etj.
	<i>Evidenca 6.1 Vendim Senati Akademik - krijimi i Zyres se Sigurimit te Breshem dhe Cilesise 23.07.2010</i> <i>Evidenca 6.2 Vendim Senati Akademik - Krijimi i Komisionit per Vleresimin Institucional 22.12.2016.</i> <i>Evidenca 6.3 Vendim Senati Akademik - Pedagoget përgjegjes per Sigurimin e Cilesise ne nivel departamenti</i> <i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>

<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se AU ka një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, duke përfshirë një strukturë të dedikuar për sigurimin e cilësisë dhe një grup punësh të përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme. Kjo politikë mbështetet në dokumente ligjore dhe strategjike si rregulloret e institucionit dhe strategjitë për cilësinë. Përmes strukturave të ndryshme, përfshirë Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit Institucional dhe Komisionin e Sigurimit të Cilësisë në nivel njësie bazë, institucioni monitoron dhe përmirëson vazhdimisht cilësinë e programeve të studimit. Përmes trajnimeve dhe vlerësimit të jashtëm, institucioni siguron që programet e studimit të përmbushin standardet e larta të cilësisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	AU ka ngritur në nivel departamenti struktura specifike për ruajtjen, përmirësimin dhe monitorimin e cilësisë. Grupet e sigurimit të cilësisë të ngritura në nivel departamenti janë komisione të ngritura Ad-hoc të cilat kanë në përbërje të tyre 2-3 anëtarë të stafit akademik të brendshëm dhe studentë. Këto komisione punojnë për rishikimin e kurrikulave, silabuseve në bashkëpunim me titullarët e lëndëve përkatëse. Gjithashtu, këto komisione kanë detyrë të hartojnë RVB për programin e studimit në raste riakreditimi.  <i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen	Sipas informacionit të paraqitur në raportin e vetëvlerësimit dhe nga takimet gjatë vizitës, u konstatua se për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve akademike, janë të përfshirë titullarët, lektorët dhe asistent-lektorët në përditësimin e syllabuseve. Departamenti, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave në AU luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin dhe nxitjen e këtyre proceseve.

<p>studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Evidencat kryesore përfshijnë vendimet e Senatit Akademik për krijimin e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm dhe Cilësisë (23.07.2010), krijimin e Komisionit për Vlerësimin Institucional (22.12.2016), si dhe përgjegjësitë e pedagogëve në nivel departamenti për sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, janë përmendur strategjia për sigurimin e cilësisë në Albanian University, miratimi i propozimeve për konsulentë për sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin e kurrikulave, si dhe rregulloret për mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesin mësimor.</p> <p>Evidenca 6.1 Vendim Senati Akademik - krijimi i Zyres se Sigurimit te Breshem dhe Cilesise 23.07.2010</p> <p>Evidenca 6.2 Vendim Senati Akademik - Krijimi i Komisionit per Vleresimin Institucional 22.12.2016.</p> <p>Evidenca 6.3 Vendim Senati Akademik - Pedagoget pergjegjes per Sigurimin e Cilesise ne nivel departamenti</p> <p>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</p> <p>Evidenca 6.5.a Miratimi i propozimit te Bordit te Administrimit - Konsulente juridike prane NJSBC Dr. Proc. Entjola Pano.</p> <p>Evidenca 6.5.b Vendimi i Bordit te Administrimit - Konsulent per zhvillimin dhe permiresimin e kurrikulave Prof. Asoc. Dr. Bedri Kola</p> <p>Evidenca 6.6 Rregullore per mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne Albanian University.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni përdor metodologji vlerësimi si dhe instrumente matëse vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit Master shkencor në “Psikologji klinike” të tilla si: metoda të tërthorta pyetësorë të studentëve (2 herë në vit); fokus grupe (në fund të vitit), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës pyetësorë për pedagogët, etj. Komisioni njofton në mënyrë zyrtare strukturat përgjegjëse dhe përgjatë procesit të monitorimit përdor format raporte që të japin mundësi të vlerësosh aspekte të ndryshme që lidhen me mënyrën sesi respektohen standartet nga strukturat përgjegjëse.</p> <p><i>Evidenca 6.3 Vendim Senati Akademik - Pedagoget pergjegjes per Sigurimin e Cilesise ne nivel departamenti</i></p>

	<i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	<p>Politika e programeve të studimit për rritjen e cilësisë përshkruhet në pikën 7 të strategjisë së zhvillimit institucional, si dhe në strategjinë e institucionit për sigurimin e cilësisë. Në përfundim të vitit akademik, ekipi i sigurimit të cilësisë NJSBC ja e departamentit përgatit një raport të vetëvlerësimit për programin e studimit. Ky raport përfshin informacion mbi vetë programin, çdo ndryshim që është bërë, planet e ardhshme për përmirësime, komente nga studentët dhe stafi akademik i përfshirë në program dhe të dhëna për përparimin e studentëve. Në përfundim të çdo semestri dhe viti akademik, njësi bazë përpilon një raport semestral dhe një raport vjetor. Këto raporte përmbajnë të dhëna përshkruese dhe sasiore që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme si statusi i programeve të studimit, vlefshmëria e akreditimit, rekrutimi i stafit akademik, shtimi i literaturës së re në bibliotekë, rezultatet e performancës së studentëve dhe një analizë SËOT.</p> <p><i>Evidenca 6.3 Vendim Senati Akademik - Pedagoget pergjegjes per Sigurimin e Cilesise ne nivel departamenti</i></p> <p><i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se AU ka ngritur struktura dhe ka hartuar politika të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, duke përfshirë grupet e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti dhe komisionet Ad-hoc. Institucioni përdor metodologji të ndryshme vlerësimi dhe instrumente matëse për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë, si pyetësorët e studentëve dhe pedagogëve, fokus grupet dhe raportet e vetëvlerësimit. Këto politika janë të përshkruara në strategjinë e zhvillimit institucional dhe përfshijnë raportet semestrale dhe vjetore të cilësisë.</i></p> <p><i>Sugjerim: Rekomandohet që AU të vazhdojë dhe të zgjerojë përpjekjet për përfshirjen e një gamë më të gjerë të interesave dhe perspektivave në proceset e sigurimit të cilësisë, duke inkurajuar bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm dhe të marrë parasysh rekomandimet e tyre për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se raportin e vetëvlerësimit të programit të studimit kryhet në përfundim të çdo viti akademik dhe ky proces përfshin të gjithë aktorët duke filluar që nga Njësia Bazë me grupet e sigurimit të cilësisë. Përsa i përket strukturës që merret me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, ai është i lidhur me NJSBC. Kjo strukturë monitoron standartet e cilësisë për të gjitha programet e studimit në rang universiteti. Grupi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë është ngritur nga departamenti me qëllim hartimin e një raporti vlerësimi të brendshëm për këtë program studimi. Kjo njësi pasi e përfundon raportin ja dërgon NJSBC e cila e përfshin në raportin e saj vjetor.</p> <p><i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i></p> <p><i>Evidenca 6.3 Vendim Senati Akademik - Pedagoget pergjegjes per Sigurimin e Cilesise ne nivel departamenti</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Universiteti “Albanian University”, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësimit të pedagogëve si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme të tilla si: pyetësori i studentëve, takimet në grup që zhvillohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që të masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit.</p>


	<p><i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i></p> <p><i>Evidenca 3.4. Fokus - Grupe</i></p> <p><i>Evidenca 6.7 Formular vleresimi nga drejtuesi i departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 6.8. Rezultatet e pyetesorit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ, nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se metodat e drejtpërdrejta të përdorura nga institucioni janë, vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore si dhe rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë etj.</p> <p><i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i></p> <p><i>Evidenca 3.4. Fokus - Grupe</i></p> <p><i>Evidenca 6.7 Formular vleresimi nga drejtuesi i departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 6.8. Rezultatet e pyetesorit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen</p>	<p>Dy herë në vit NJSBC realizon pyetësorë me studentët aktualë, si dhe një herë në vit fokus grupe. Gjithashtu, AU ka ndërmarrë dhe vlerësimin e personelit akademik me kohë të plotë. Duke iu referuar RVB dhe intervistave gjatë vizitës në AU konstatuam se zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte të vazhdueshme me Alumnin. AU nuk ka evidence që arrin të marrë feedback nga tregu i punës apo punëdhënës më të cilët bashkepunon në kuadër të realizimit të programit të studimit</p> <p><i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i></p> <p><i>Evidenca 3.4. Fokus - Grupe</i></p> <p><i>Evidenca 6.7 Formular vleresimi nga drejtuesi i departamentit</i></p> <p><i>Evidenca 6.8. Rezultatet e pyetesorit</i></p>

në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.									
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe gjatë takimeve në institucion, GVJ konstaton se AU monitoron dhe vlerëson periodikisht programin e studimit përmes njësive të posaçme si NJSBC dhe grupet e sigurimit të cilësisë. Procesi përfshin vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, monitorimin e silabuseve, vlerësimet e pedagogëve dhe përdorimin e pyetësorëve dhe fokus grupeve me studentët. Raportet e vetëvlerësimit përgatiten çdo vit akademik dhe përfshijnë të gjithë aktorët relevantë. Institucioni gjithashtu përdor metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar ecurinë dhe cilësinë e programit, duke përfshirë statistikat e kalueshmërisë dhe rishikimin e vazhdueshëm të kurrikulave.</i></p> <p><i>Sugjerim: Rekomandohet që AU të përmirësojë frekuencën dhe diversitetin e metodave të monitorimit dhe vlerësimit, duke përfshirë më shumë input nga tregu i punës dhe praktikant ndërkombëtare për të siguruar që programi të mbetet i përditësuar dhe relevant.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Universiteti “Albanian University” garanton politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë, kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të paramentrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p><i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i></p>



	<i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton së detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të palëve të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në rregulloren e NJSBC. NJSBC përmes aktiviteteve që ndërmerr synon të garantojë sigurimin e cilësisë.  <i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i> <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon grupi i vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmësakademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin.  <i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i> <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i>
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtrojnë detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë. Gjithashtu, edhe përfshirja e studentëve në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.  <i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i> <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i> <i>Evidenca 6.10 Kodi i Etikes</i>
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të	Përbërja e GVB është e përbërë vetëm nga anëtarë të brendshëm të departamentit dhe një student. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndryshëm, me të cilët departamenti




<p>cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>bashkëpunon mund të ishte një mundësi e mirë për marrjen e opinioneve që do të përmirësonin cilësinë e këtij programi studimi.</p> <p><b><i>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ sugjeron se institucioni duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë sugjerimeve dhe rekomandimeve të lëna nga ekspertët e jashtëm.</i></b></p> <p><i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti “Albanian University” përfshin njësitë akademike, personelin akademik dhe studentët në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni bashkëpunon me ekspertë të jashtëm dhe respekton rregulloren e NJSBC për përfshirjen dhe përgjegjësitë e palëve. Grupi i vlerësimit të brendshëm përfshin anëtarë të personelit akademik dhe studentë, duke siguruar integritet dhe barazi. Institucioni informon palët e interesuara për rezultatet dhe masat e marra. GVJ sugjeron përfshirjen më të madhe të ekspertëve të jashtëm për të përmirësuar cilësinë e programit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


<p><b>Standardi VI.5</b>  <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Master shkencor në “Psikologji klinike” janë transparente. Politikat e institucionit në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish, janë krijuar në funksion të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e AU. Në funksion të trasparencës do të ishin të nevojshme vijimi i praktikës së mirë të nisur si diskutimet me stafin dhe studentët, fokusgrupet e ndryshme, etj. Këto veprimtari do të ndihmonin trasparencën në ndarjen e informacionit me palët e interesuara dhe të përfshira, dhe gjithashtu do të lejonin marrjen e</p>



	<p>një feedback-u mbi mundësinë e përmirësimit të punës së grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.</p> <p><i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>  <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike – profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e AU. Raportet janë pasqyruar të plota pa ndërhyrje në shmangien e dajles së të dhënave për personat që janë pjesë e të dhënave që kanë kontribuar në drejtim të mësimdhënies në këtë program studimi këto vite, megjithatë të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt që mbajnë dhe nuk ka evidenca që na japin mundësi të gjykojmë mbi cënimin e lirisë për të dhënat personale.</p> <p><i>Evidenca 6.11 Raport Vjetor Institucional v.a 2021-2022</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se insitucioni sigurohet që raportet dhe rezultatet e vetëvlerësimit të programit përfshijnë edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi. Institucioni në këto dokumenta kryen dhe adresimin e masave që duhen analizuar dhe reflektuar. Grupi i vlerësimit të brendshëm ka paraqitur rezultatet e vlerësimit të tij për këtë program studimi. Në përmbyllje të raportit të tij ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe pikat e dobëta. <i>Ka një tendencë për t'u fokusuar në evidentimit e pikave të forta dhe afirmimet më tepër, dhe përsa i përket sugjerimeve për masat që mund të ndërmerren në drejtim të pikave të dobëta mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore, por edhe institucioni për të përmirësuar ato në të ardhmen.</i></p> <p><i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>  <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron</p>	<p>Universiteti “Albanian University”, në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, krijon NJSBC. Puna e tij perfundon me</p>



<p>efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Raportin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, i cili përdoret nga vet institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, si dhe ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm.</p> <p><i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>  <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në Universitetin “Albanian University”, GVJ konkludon se institucioni me anë të veprimtarive periodike si java e orientimit, sesione trajnimi të shumta që realizon në fillim të çdo viti akademik, realizon shumë mirë informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve dhe stafit akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Një sërë strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (NJSBC, GVB) staf akademik dhe studentë me qëllimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë si një detyrim që e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret e AU, statuti, etj.</p> <p><i>Evidenca 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise ne Albanian University</i>  <i>Evidenca 6.9 Rregullore Njesia e Sigurimit te Brendshem dhe te Cilesise</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se Universiteti "Albanian University" ka politika dhe veprimtari transparente dhe efektive për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat synojnë krijimin e një kulture të cilësisë. Informacioni mbi vlerësimet e brendshme dhe raportet e cilësisë publikohen në faqen e AU dhe diskutohen me stafin dhe studentët. Institucioni respekton të dhënat e privatësisë dhe etikën akademike, ndërsa raportet përfshijnë masa për përmirësim dhe analiza të pikave të forta dhe të dobëta. Aktivitetet periodike dhe trajnime për stafin dhe studentët promovojnë ndërgjegjësimin për rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave “Psikologji Klinike” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Albanian University”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi Master Shkencor ngrihet mbi programin Bachelor i cili është tashmë i konsoliduar prej vitesh;
2. Institucioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm konkretë për mbështetjen financiare të kërkimit shkencor të pedagogëve si dhe përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor përmes Zyrës për Kërkimin Shkencor dhe Botimeve Akademike;
3. Pjesëmarrja aktive e studentëve në vlerësimet e rregullta të metodave të mësimdhënies dhe performancës së fakultetit;
4. Qasje në bibliotekat online dhe platformat elektronike për të mbështetur procesin e mësimdhënies;
5. Komunikimi pozitiv dhe efektiv mes stafit akademik dhe studentëve në kuadër të këtij programi studimi;
6. Promovimi i shkëmbimeve të arsimit të lartë si për stafin akademik ashtu edhe për studentët përmes Erasmus+;
7. Aktivitetet jashtëshkollore të ofruara nga institucioni që rrisin mundësitë e kërkimit shkencor si për stafin akademik ashtu edhe për studentët në këtë program;
8. Infrastrukturë fizike adekuate që u ofron studentëve kushte të përshtatshme për procesin mësimor në këtë program studimi;

**Pika të dobta:**

1. Mungon evidenca në formën e raporteve analitike për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në funksion të realizimit të programit të studimit në drejtim të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor, tregut të punës etj; (Standardi I-3 kriteri 2/3)
2. Literatura në syllabuse është tepër e vjetër, mbi 10 ose 20 vjecare; (Standardi II-4 kriteri 3/5)
3. Një pjesë e personelit akademik me kohë të pjesshme (PAK) e angazhuar në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në Psikologji Klinike, rezulton të jetë me nivel MSc të kualifikimit. (Standardi IV 1 kriteri 1)

**Rekomandime:**

1. Departamenti duhet të hartojë raporte analitike për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në funksion të realizimit të programit të studimit në drejtim të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor, tregut të punës etj;
2. Në mënyrë që studentët të jenë konkurrues jo vetëm në nivel kombëtar por edhe ndërkombëtar nevojitet një përditësim i programit dhe syllabuseve me zhvillimet/literaturën më të fundit të fushës;

3. Të shtohen përpjekjet institucionale për të parashikuar rritje të buxhetit për sigurimin e literaturës së nevojshme në mbështetje të programit të studimit të marrë në vlerësim;
4. Institucioni të rekrutojë staf akademik me kontratë me nivel kualifikimi sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”;

**Evaluation’s conclusions for the second cycle study program Master of Science in "Clinical Psychology" provided by the Higher Education Institution "Albanian University"**

**Strengths and Affirmations:**

1. The Scientific Master's program rises above the Bachelor's program, which has already been consolidated for years;
2. The institution has undertaken important concrete steps for the financial support of the scientific research of lecturers as well as the involvement of students in scientific research through the Office for Scientific Research and Academic Publications;
3. Active participation of students in regular evaluations of teaching methods and faculty performance;
4. Access to online libraries and electronic platforms to support the teaching process;
5. Positive and effective communication between academic staff and students within this study program;
6. Promotion of higher education exchanges for both academic staff and students through Erasmus+;
7. Extracurricular activities offered by the institution that increase scientific research opportunities for both academic staff and students in this program;
8. Adequate physical infrastructure that offers students suitable conditions for the learning process in this study program;

**Weaknesses:**

1. There is a lack of evidence in the form of analytical reports for the implementation of cooperation agreements at the national and international level in order to realize the study program in terms of professional training, scientific research, the labor market, etc.;
2. The literature in the syllabus is very old, over 10 or 20 years old;

**3. A part of the part-time academic staff (PAK) engaged in the realization of the study program Master of Science in Clinical Psychology, turns out to be at the MSc level of qualification.**

**Recommendations:**

**1. The department must draft analytical reports for the implementation of cooperation agreements at the national and international level in order to realize the study program in terms of professional training, scientific research, the labor market, etc.**

**2. In order for students to be competitive not only at the national but also international level, an update of the program and syllabuses is needed with the latest developments/literature in the field.**

**3. To increase the institutional efforts to foresee an increase in the budget for the provision of the necessary literature in support of the study program taken in the evaluation.**

**4. The institution recruits academic staff with a contract with a qualification level according to the provisions in Law No. 80/2015 "On Higher Education and Scientific Research in the Republic of Alban**





**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>			X	
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË</b>			X	
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

